



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 38 regjistër (JR)  
Datë 06.09.2022

Nr. 43 i vendimit  
Datë 27.05.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 27.05.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 38/2022 (JR), datë 06.09.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Altin Abdiu, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 543, datë 28.06.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; Kodi i Procedurës Civile; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të depozituara në Kolegji, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 543, datë 28.06.2022, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Altin Abdiu, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup> dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>5</sup>, duke konstatuar se:
  - (i) Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.
  - (ii) Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve.
  - (iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
  - (iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë.
  - (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

<sup>1</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017

<sup>2</sup> Dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.01.2017, referuar vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2017, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe marrësi në dorëzim nga ILDKPKI-ja. Të njëjtën datë mban edhe deklaratata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

<sup>3</sup> Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 30.01.2017.

<sup>4</sup> Dorëzuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 30.01.2017, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim më datë 30.01.2017.

<sup>5</sup> Dërguar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2018.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu për vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Altin Abdiu, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 543, datë 28.06.2022, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
  - Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Trupi gjykues arrin në përfundimin se: (i) Lidhur me pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm. (ii) Lidhur me pasurinë e llojit “vilë” 2-katëshe, të ndodhur në {\*\*\*}, Kavajë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të saj, si edhe rezultoi se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të shlyer vlerën e plotë të kësaj pasurie, ku përfshihet edhe pagesa e pjesës takuese të subjektit, e deklaruar si e dhuruar në favor të tij. (iii) Lidhur me automjetin e markës “Mercedes Benz”, blerë në maj të vitit 2008, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij. (iv) Lidhur me automjetin e markës “Mercedes Benz”, blerë në tetor të vitit 2009, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij. (v) Lidhur me depozitën në shumën 20.000*

euro, gjendje në Credins Bank, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e saj. (vi) Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

➤ Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Altin Abdiu ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

➤ Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 543, datë 28.06.2022, duke e kundërshtuar atë si vendim të padrejtë, të pambështetur në ligj dhe në prova. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi objekt ankimi është marrë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të përcaktuara në nenin 6 të KEDNj-së dhe në nenin 42 të Kushtetutës; në interpretim të gabuar të provave të administruara gjatë hetimit administrativ; nuk është arsyetuar plotësisht, si dhe është rezultat i vlerësimit të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
10. Subjekti i rivlerësimit, ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shkresore në cilësinë e provave të reja në proces. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, të vendosë:
  - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
  - *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
  - *Çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja.*
  - *Ndryshimin e vendimit nr. 543, datë 28.06.2022, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1. *Subjektit të rivlerësimit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj.*

11.2. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se është shkelur neni 7 i KEDNj-së për shkak se, sipas tij, është cenuar parimi i sigurisë juridike.*

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, është i pambështetur në provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar.*

12.2. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, në Njësinë Bashkiake nr. 7, Tiranë, është i padrejtë, kontradiktor në raport me provat e administruara dhe qëndrimin transparent dhe bashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, marrëdhënia e shkëmbimit mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe familjarëve Abdiu është e vërtetë dhe ka ndodhur realisht.*

12.3. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme shtëpi dykatëshe (një kat plus papafingo) e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Kavajë, te kompleksi turistik “{\*\*\*}” në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, është konkluzion i gabuar.*

12.4. *Konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, është i pabazuar.*

12.5. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së llojit “likuiditete” në formën e depozitës bankare me afat njëvjeçar në Credins Bank, në shumën 20.000 euro të investuar në datën 11.11.2016, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, është konkluzion i pabazuar dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit.*

12.6. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë së llojit “likuiditete”, gjendje cash, në shumën 5.000 euro, është i pabazuar.*

12.7. *Konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga shitja në vitin 2003 e pasurisë së llojit automjet i tipit “Mercedes Benz”, është konkluzion i pabazuar në ligj.*

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin kalimtar të subjektit Altin Abdiu, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>6</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 543, datë 28.06.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

16. Pas regjistrimit në Kolegj të çështjes nr. 38/2022 (JR), datë 06.09.2022, që i përket ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit Altin Abdiu, ky i fundit ka depozituar në Kolegj më datë 11.02.2025, një dokument të titulluar “Parashtrime shtesë”, bashkëlidhur të cilit ka depozituar edhe

---

<sup>6</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 543, datë 28.06.2022, për rivlerësimin e subjektit Altin Abdiu, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.07.2022, konfirmuar marrja dijeni më datë 05.08.2022, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision më datë 19.08.2022, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {\*\*\*}, datë 09.08.2022, që rezulton të jetë dita e 14 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.

disa akte në cilësinë e provave të reja në proces, për të cilat, bazuar në parashikimet e nenit 51, pika 1, shkronja “a” dhe të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, kërkoi që të pranohen për shqyrtim dhe të administrohen në këtë proces, duke e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore publike.

17. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për marrjen e provave të reja, referuar këtu akteve shkresore që subjekti i kishte bashkëlidhur ankimit dhe atyre të depozituara në Kolegj më datë 11.02.2025, trupi gjykues, pasi e mori në shqyrtim këtë kërkesë, vlerësoi se sa u takon akteve shkresore të depozituara nga subjekti në Kolegj, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

17.1. Sa u takon akteve të depozituara bashkëlidhur ankimit<sup>7</sup>, trupi gjykues konstatoi se dy deklaratat noteriale të prindërve të subjektit të rivlerësimit përmbajnë deklarime të cilat janë dhënë edhe gjatë hetimit administrativ, njëra prej tyre shoqërohet nga dy kontrata, të cilat po ashtu janë të administruara në dosjen e krijuar nga Komisioni. Si të tilla, këto akte nuk çmohen se mund të vlerësohen si prova të reja në proces dhe, rrjedhimisht, nuk lind nevoja për administrimin e tyre.

17.2. Sa u takon akteve të depozituara bashkëlidhur parashtrimeve në funksion të shkakut të ankimit lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë<sup>8</sup>, trupi gjykues vëren se subjekti ka pretenduar se nuk ka mundur t’i sigurojë më parë në kohë këto akte, duke justifikuar dorëzimin e tyre vetëm në këtë moment. Ky pretendim nuk konstatohet të jetë mbështetur me ndonjë provë të përpjekjeve të dështuara të subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim. Në lidhje me nevojën për t’i administruar këto akte si prova të reja në proces, trupi gjykues vëren se në rastin konkret, bëhet fjalë për dy komunikime shkresë/vërtetim, të cilat konfirmojnë pretendimet e subjektit, por përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë shoqëruar me dokumente provuese. Ndërkohë, lidhur me aktin e ekspertimit teknik të datës datë 07.10.2024, trupi gjykues vlerëson se ky dokument nuk kishte asnjë pengesë për t’u kërkuar dhe dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të zhvilluar në Komision, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ka referuar edhe lidhur me një shtesë të dytë, anësore, të pallatit në rrugën

---

<sup>7</sup> 1. “Deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2022, e z. F. A., si dhe dokumentacioni bashkëlidhur kësaj deklaratë. 2. Deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2022, e znj. K. A.”.

<sup>8</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 15.04.2024, e përfaqësuesit me prokurë të përgjithshme të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e shoqëruar nga prokura e përgjithshme nr. rep. {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, datë 05.10.2021, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga administratorja V. H., dhe ekstrakti i regjistrit tregtar për studion ligjore “{\*\*\*}”, dhe vërtetimi i datës 03.03.2014, i administratores së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, znj. V. H., shoqëruar me ekstraktin e regjistrit tregtar të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

“{\*\*\*}”. Në këto kushte, këto akte u vlerësuan se nuk përmbushin kriteret procedurale për pranueshmërinë e tyre si prova të reja në proces.

17.3. Lidhur me aktet e depozituara bashkëlidhur parashtrimeve në funksion të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me pasurinë e paluajtshme shtëpi dykatëshe e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Kavajë, te kompleksi turistik “{\*\*\*}, trupi gjykues vëren se: (i) lidhur me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2022, të znj. K. A., sipas së cilës ajo deklaroi se ka hequr dorë nga të gjitha të drejtat mbi pasurinë vilë dykatëshe në {\*\*\*}, Kavajë, për të cilën së bashku me shtetasin N. H. kanë lidhur kontratë porosie me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.10.2000, para noterit A. Z., me sipërmarrës shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, pasi pjesën e saj prej ½ të kësaj pasurie ia ka shitur shtetasit N. H., kundrejt vlerës 40.000 USD, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë për depozitimin e këtij akti në përputhje me parashikimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, që në kohën kur zhvillohej procesi i rivlerësimit në Komision, për sa kohë ky i fundit në dokumentin e rezultateve të hetimit ka konstatuar mungesën e një dokumenti shkresor, sipas të cilit znj. K. A. të kishte hequr dorë nga të drejtat e saj mbi këtë pasuri. Trupi gjykues vlerësoi për më tepër se vlera provuese e këtij akti çmohet pa efekt domethënës për sa kohë bëhet fjalë për një deklaram të njëanshëm, përmbajtja e të cilit rezulton edhe nga një deklaratë e mëparshme e datës 09.03.2022, e të njëjtit person<sup>9</sup>; (ii) sa i takon akteve të cilat lidhen me pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi të drejtat e pronësisë së z. N. H. në objektin vilë dykatëshe e ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK<sup>10</sup>, trupi gjykues vlerëson se këto akte plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në drejtim të vlerësimit të pranueshmërisë së tyre si prova të reja në gjykim, sa kohë provohet për shkak të datës së këtyre akteve dhe përpiluesve të tyre se pamundësia për depozitimin e tyre në Komision nuk ka qenë për faj të subjektit të rivlerësimit. Konstatohet gjithashtu se aktet janë të mëvonshme edhe në raport me datën e depozitimit të ankimit nga subjekti i rivlerësimit. Sa i takon nevojës për administrimin e këtyre akteve në proces, trupi gjykues konstatoi se: (i) bazuar në vendimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me nr. {\*\*\*}, datë 26.02.2024, “Për kalimin e pronësisë mbi truallin funksional/të lirë brenda zonës së stimuluar dhe legalizimin e ndërtimit pa leje”, me të cilin është vendosur kalimi i pronësisë, mbi pasurinë truall funksional me nr. {\*\*\*},

<sup>9</sup> Shih deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.03.2022 të dhënë nga zj. K. A.

<sup>10</sup> 1. Kërkesë për përfshirje në procesin e legalizimit, datë 12.10.2022, drejtuar drejtorisë vendore të ASHK për zonat e stimuluar nga N. H., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. B. M.. 2. Shkresë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2022, me anë të së cilës është vënë në dispozicion të përfaqësuesit me prokurë të z. N. H., kopje e njëzuar me vulë sekretarie e praktikës nr. {\*\*\*} prot., datë 08.10.2010, me subjekt vetëdeklarues N. H. H., shoqëruar me prokurën e posaçme nr. rep. {\*\*\*} dhe nr. kol. {\*\*\*}, datë 26.09.2022. 3. Shkresë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. {\*\*\*} prot., datë 05.03.2024, drejtuar z. N. H., me anë të së cilës është përcjellë dokumentacioni tekniko-ligjor, si dhe vendimi për legalizimin e ndërtimit pa leje. 4. Aplikim nr. {\*\*\*}, datë 21.05.2025, i N. H., përfaqësuar nga av. B. M. pranë ASHK-së për regjistrimin e lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2024. 5. Certifikatë Regjistrimi Pronësie e datës 24.07.2024, për pasurinë objekt kontrolli, me nr. pasurie {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, shoqëruar me Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme dhe fragmentin e hartës kadastrale për shtetasin N. H.. 6. Vërtetim i datës 09.05.2023, i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Tiranë dhe procesverbali i datës 20.06.2005, i mbajtur midis K. A. dhe N. H., i vërtetuar nga përfaqësuesi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. S. N.. 7. Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.01.2024, e shtetasit N. H..

në zonën e stimuluar “{\*\*\*}” ShPK, Zona Kadastrale nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe takuese sipas gendplanit 419,00 m<sup>2</sup> dhe vlerë 825.430 lekë [...], dhe legalizimi i njësisë ndërtimore, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr. {\*\*\*} prot., datë 08.10.2010 [...] është lëshuar Certifikata për Regjistrimin e Pronësisë në emër të N. H. mbi pasurinë e paluajtshme me nr. {\*\*\*} në Zonën Kadastrale nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe totale 419 m<sup>2</sup>, nga të cilat truall 419 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 97,69 m<sup>2</sup>; (ii) regjistrimi i kësaj pasurie në emër të z. N. H. është bërë në kuadër të një aplikimi të kryer nga znj. S. K. në emër të z. N. H. në datën 08.10.2010, si subjekt i vetëm i interesuar i njësisë së ndërtuar në zonën e stimuluar “{\*\*\*}” Golem, sipas kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.10.2005, të lidhur para noterit A. Z., mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. N. H. në cilësinë e porositësit të vilës dykatëshe me sip. ndërtimi 214 m<sup>2</sup>, e specifikuar me nr. {\*\*\*}, në Golem, e cila rezulton të jetë e njëjta pasuri me atë objekt të kontratës së porosisë së lidhur në vitin 2000 mes znj. K. A. dhe z. N. H. me shoqërinë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, për zbatimin e së njëjtës leje ndërtimi. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se, ndonëse këto akte përmbushin kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, ato u vlerësuan të panevojshme sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se trupi gjykues mund të arrinte në vendimmarrje lidhur me këtë çështje, nga shqyrtimi mbi bazë të dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit.

18. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit të fashikullit të administruar gjatë procesit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm, dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së kryer lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërkimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë publike, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni*

19. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:*

19.1. Komisioni nuk përmbush standardin e vendosur nga GjEDNj-ja, në drejtim të plotësisimit të 4 kritereve që përcaktojnë nëse një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve përbën një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, më konkretisht sa i takon:

(i) *Përfaqësimit thelbësor të komunitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përbërjen e organit disiplinor.* Referuar këtij kriteri, sipas subjektit të rivlerësimit, rezultoi që asnjë prej 12 komisionerëve të Komisionit nuk vjen nga radhët e sistemit gjyqësor në momentin e caktimit në detyrë.

(ii) *Procedurës së caktimit të anëtarëve të organit disiplinor, dhënies së garancive ndaj presioneve të jashtme.* Lidhur me këtë kriter, subjekti pretendoi se të 12 komisionerët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet parlamentar specifik *ad hoc* dhe janë caktuar nga Parlamenti pa përfshirjen e trupës gjyqësore. Sipas subjektit të rivlerësimit, formimi i Komisionit dhe, për rrjedhojë, edhe i trupës gjyqësore që ka shqyrtuar çështjen e tij bie ndesh me vendimin e GjEDNj-së të datës 12 mars 2019, lidhur me çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës*, ku sipas subjektit, GjEDNj-ja ka vendosur se shkelja e kritereve ligjore për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Apelit përbën shkelje të garancisë së nenit 6/1 të KEDNj-së për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme. Anëtarët që kanë shqyrtuar çështjen ndaj ankuesit nuk kanë përmbushur, sipas këtij të fundit, kërkesat e përzgjedhjes, të përcaktuara me ligjin nr. 84/2016. Ky ligj, sipas subjektit, përcakton kritere strikte, por nuk parashikon se si do të verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve nga Presidenti, Avokati i Popullit apo ONM-ja. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se të katër anëtarët e Komisionit që kanë shqyrtuar çështjen e tij, përfshirë dhe komisioneren E. Ç. (e cila u përjashtua nga trupi gjyqësor me kërkesë të subjektit), nuk plotësojnë të paktën një nga kriteret e përcaktuara nga Kushtetuta për të qenë komisionerë, kriterin e përvojës si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Ky fakt, sipas tij, është lehtësisht i verifikueshëm nga CV-ja e tyre. Në kuadër të të provuarit të këtij fakti, subjekti i rivlerësimit është shprehur në ankim se ka përcjellë në cilësinë e akteve provuese bashkëlidhur ankimit: (i) shkresën e Avokatit të Popullit nr. {\*\*\*}, datë 03.03.2017, nëpërmjet së cilës është përcjellë në Kuvend lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret ligjore, në të cilën përfshihen edhe anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që kanë shqyrtuar çështjen e rivlerësimit ndaj tij; dhe (ii) shkresën e Avokatit të Popullit nr. {\*\*\*}, datë 17.07.2020, nëpërmjet së cilës Avokati i Popullit informon shoqatën “Drejtësi për Drejtësinë” për problemet e rënda që ka pasur procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit.

19.2. Komisioni nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative, duke e kthyer seancën dëgjimore në një seancë tërësisht formale, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve. Subjekti pretendoi se nuk është pranuar asnjë argument i paraqitur prej tij, madje as argumente për të cilat ka *vendim njëses* të Kolegjit, duke referuar këtu vendimet orientuese lidhur me shpenzimet e jetesës përpara vitit 2000, apo në lidhje me kursimet në gjendje *cash*. Subjekti pretendoi edhe se Komisioni, në mënyrë tendencioze, ka

rënduar në vendim rezultatin e analizës financiare dhe ka përdorur shprehje ofenduese për subjektin dhe familjarët e tij, të pabazuara dhe të panjohuara subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, të tilla si: “vendosja e prindërve të tij si mburojë për përfitimin e çdo pasurie të paluajtshme, mbi të cilën ai disponon të drejta reale/pronësie”, ose: “veprimet dhe deklaratimet e tij kanë pasur si qëllim bërjen të pamundur të verifikimit të mënyrës së përfitimit dhe burimit real të krijimit të këtyre pasurive”.

20. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mungesa në përbërje të Komisionit e anëtarëve me prejardhje profesionale nga sistemi gjyqësor, si dhe problematikat e pretenduara në procedurën e caktimit të anëtarëve të organit disiplinor, të cilat ndikojnë në kriterin e dytë, atë të dhënies së garancive ndaj presioneve të jashtme të këtij organi, cenojnë paanësinë dhe pavarësinë e trupave gjykuese të tij, referuar kriterëve të përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së<sup>11</sup> për një organ disiplinor, me efekt cenimin e nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues, në shqyrtimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, referuar edhe qëndrimit të deritanishëm në vendimmarrje të mëparshme të tij, mban në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur nga Kushtetuta si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit<sup>12</sup>. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur komisionerë. Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arritur në konkluzionin se *nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanësisë*.
21. Duke përmbyllur analizën e mësipërme, trupi gjykues thekson se një pretendim i tillë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.
22. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mosplotësimin nga anëtarët e trupit gjykues që kanë gjykuar çështjen e tij në Komision, të një prej kriterëve për t’u zgjedhur komisionerë, të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se, përveç faktit që Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar në mosvlerësimin e këtyre shkaqeve, si pasojë e

<sup>11</sup> Subjekti referon në ankim vendimin e GjEDNj-së për çështjen *Oleksandr Volkov v. Ukraine*.

<sup>12</sup> Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Aneksit të Kushtetutës.

faktit që këto pretendime tejkalojnë kompetencat juridiksionale të tij, ky pretendim i subjektit mbeti në nivel deklarativ dhe i paprovuar, për sa kohë edhe aktet të cilat ka referuar në ankimin e tij, se i sjell si provë të faktit të pretenduar të mosplotësimit të kriterit të sipërcituar ligjor, nuk rezulton t'i ketë depozituar në Kolegj bashkëlidhur ankimit. Në këto kushte, ky pretendim u çmua se nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut ligjor, i cili të mund të cenojë vendimmarrjen e trupit gjykues të Komisionit.

23. Ndërsa, sa u takon pretendimeve të pasqyruara në paragrafin 19.2 më sipër, në këtë vendim, trupi gjykues vëren se ato lidhen me vlerësimin në themel të çështjeve që i përkasin vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, këto pretendime në drejtim të mosvlerësimit të provave, mosmarrjes në konsideratë të argumenteve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij apo gjatë seancës dëgjimore, si dhe vlerësimi nga Komisioni i çështjeve të caktuara, të pretenduara jo në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, janë mbajtur në konsideratë dhe janë vlerësuar nga trupi gjykues në vijim, në shqyrtimin e shkaqeve të ngritura në ankim lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë.
24. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se është shkelur neni 7 i KEDNj-së për shkak se, sipas tij, është cenuar parimi i sigurisë juridike.* Këtë shkak të ankimit, subjekti e mbështeti në pretendimet se: (i) rregullat e përcaktuara në procesin e rivlerësimit dhe sidomos në procesin e zhvilluar ndaj tij janë të padrejta dhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike; (ii) në procesin e rivlerësimit, subjekteve u jepet masa disiplinore e “shkarkimit nga detyra” për pasaktësitë apo shkeljet administrative që mund të kenë kryer në deklaratimet periodike vjetore dhe, për pasojë, në këtë rast cenohen parimet e njohura “nullum crimen, nulla poena sine lege” dhe “mens rea”; (iv) në vendimin e ankuesit janë përdorur koncepte të paqarta dhe të papërcaktuara, sikurse janë “pasaktësi në deklarinimin e burimeve financiare”, “deklarim i pamjaftueshëm i të ardhurave” “deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”, koncepte këto të cilat, sipas subjektit, nuk janë sqaruar as nga ligji nr. 84/2016; (v) ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar masa të nevojshme procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit përkatës material, duke cenuar në këtë mënyrë dukshëm parimin e sigurisë juridike.
25. Lidhur me këtë shkak të ankimit për cenim të parimit të sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, cenim të nenit 7 të KEDNj-së, i cili, referuar sa më sipër parashtruar, adresohet në drejtim të rregullave dhe procedurave të parashikuara nga ligji nr. 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, trupi gjykues vlerëson se ky shkak është i pabazuar në ligj, për sa kohë pretendime të njëjta janë ngritur edhe para Gjykatës Kushtetuese, e cila, pasi ka kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së këtij ligji, me anë të vendimit të saj nr. 2, datë 18.01.2017, e ka gjetur atë në përputhje me Kushtetutën. Çdo pretendim konkret lidhur me interpretim të gabuar/arbitrar të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, është objekt i kontrollit nga ana e Kolegjit gjatë vlerësimit të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni për çështjet objekt ankimi.

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

26. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pambështetur në provat e administruara, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë këtë proces, të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
27. Subjekti i rivlerësimit e mbështet këtë shkak ankimi në arsyetimin se, nga interpretimi sistematik i neneve 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kontrollin e pasurisë, është parashikimi në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 (kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë), në situatat kur Komisioni nuk gjen dëshmi pozitive për fshehje të pasurisë. Sipas subjektit, nëse ai nuk ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë kontrollit të pasurisë, ai duhet të konsiderohet se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, në kuptim të parashikimit të nenit 59, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
28. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prohimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke e gjetur pretendimin e subjektit, se i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kontrollin e pasurisë, është parashikimi në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si të pabazuar në ligj. Ky qëndrim është tashmë i konfirmuar edhe nga vendimmarrjet e GjEDNj-së<sup>13</sup> lidhur me çështjet e rivlerësimit të gjykuara nga kjo gjykatë.
29. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuara të konkluzioneve të Komisionit për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, në Njësinë Bashkiake nr. 7, Tiranë, trupi gjykues konstatoi si vijon.
30. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar “vetting”, në lidhje me mënyrën e fitimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kundërshtim me kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionit, në analizë përfundimtare të marrëdhënies së deklaruar dhe asaj të dokumentuar me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, dhe familjarëve Abdiu, si edhe duke pasur në konsideratë deklaramit kontradiktore të bëra në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të dy pasurive, apartamenteve të ndodhura në objektin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë (njëri prej të cilëve është pasuria objekt

---

<sup>13</sup> Shih vendimet lidhur me rastin *Xhoxhaj, Sevdari etj.*

vlerësimi), Komisioni arrin në përfundimin se veprimet dhe deklaratimet e tij kanë pasur si qëllim bërjen të pamundur të verifikimit të mënyrës së përfitimit dhe burimit real të krijimit të këtyre pasurive<sup>14</sup>. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se: [...] nga analizimi në harmoni i deklaratimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit me dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, trupi gjykues çmon se shuma prej 4.100.000 lekësh (pasqyruar si pagesë e këstit të parë në funksion të kontratës së porosisë, të lidhur nga babai i subjektit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2000) ka shërbyer si burim për krijimin e pasurive të përfituara prej familjarëve Abdiu nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas vetëdeklarimit të bërë, të dy apartamenteve të ndodhura në kullën nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, të objektit të ndërtuar nga kjo shoqëri në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë, pasuri të cilat në momentin e dorëzimit të deklaratës “vetting” kanë qenë në posedim të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij. [...] trupi gjykues nuk u bind mbi vërtetësinë e marrëdhënies së shkëmbimit mes shoqërisë “{\*\*\*}” sh.p.k. dhe familjarëve Abdiu, kjo pasi, [...] rezulton e provuar se: (i) babai i subjektit kishte lidhur më parë një kontratë porosie me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, dhe kishte kryer pagesa në funksion të kësaj kontrate; (ii) pasuria objekt shkëmbimi (pasuria e familjes Abdiu) ishte vendosur si kolateral për sigurim kredie; (iii) apartamenti objekt shkëmbimi figuron edhe sot de jure në pronësi të familjes Abdiu; (iv) në deklaratën e shkëmbimit nuk është pasqyruar dokumentacioni mbi bazën e të cilit palët dispononin të drejta pronësie/reale mbi pasuritë e dakordësuara për shkëmbim, si edhe nuk janë përcaktuar saktësisht dhe me të dhëna të plota pasuritë, apartamentet objekt shkëmbimi; si edhe (v) në deklaratën e shkëmbimit nuk është referuar fakti i dhënies së një vlere monetare në funksion të kësaj marrëdhënieje (të paktën sipas vetëdeklarimit të subjektit, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, babai i tij i kishte dhënë më parë shumën 2.500.000 lekë, krahas apartamentit në “{\*\*\*}”, në funksion të përfitimit të dy pasurive në objektin e ndërtuar prej saj).

31. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë e sipërcituar si të padrejtë, kontradiktor në raport me provat e administruara dhe qëndrimin e tij transparent dhe bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, duke pretenduar se, ndryshe nga Komisioni, marrëdhënia e shkëmbimit mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe familjarëve Abdiu është e vërtetë dhe ka ndodhur realisht. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:

31.1. Pasaktësia në deklarin, referuar vetëm mosdeklarimit të kalimit të shumës 2.500.000 lekë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përpara marrëdhënies së shkëmbimit nga babai i subjektit, ka ardhur jo vetëm si pasojë e faktit se e gjithë marrëdhënia me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK është mbajtur prej tij, por edhe për shkak të problemeve që ka pasur kjo shoqëri në marrëdhëniet e krijuara me klientët, si dhe në respektimin e procedurave për regjistrimin e pallateve që ndërtonte në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, ai ka deklaruar ekzaktësisht faktet që pasqyrohen në deklaratën

---

<sup>14</sup> Shih paragrafin 33.29 të vendimit të Komisionit.

noteriale të vitit 2002 të administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe babait të tij, i cili është dokumenti i vetëm që i është dhënë prej babait.

31.2. Ankuesi pretendoi se nuk ka pasur dijeni për pagimin e shumës 2.500.000 lekë nga babai i tij dhe, menjëherë sapo ka ardhur në dijeni të këtij fakti, e ka deklaruar atë gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni. Subjekti pretendoi gjithashtu se të njëjtat fakte ka deklaruar edhe në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, para ILDKPKI-së, ndryshe nga babai i tij, i cili, në deklarinimin e tij fillestar, ka deklaruar: *Ky apartament, së bashku me apartamentin që disponon djali im Altini, janë këmbyer me dy apartamente që kishim në rrugën “{\*\*\*}”, pallati nr. {\*\*\*}, shkalla nr. {\*\*\*}. Diferenca e sipërfaqes së tyre, likuiduar me një kredi dhe me kursimet tona nga pagat.*

31.3. Subjekti pretendoi se, sikundër ka rezultuar gjatë hetimit administrativ, apartamentin e porositur fillimisht nga babai i tij, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, të lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, kjo e fundit ia ka shitur një personi tjetër, z. M. Z., sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 08.02.2001. Subjekti pretendoi gjithashtu se i njëjti sipërmarrës nuk ka regjistruar ende në ZVRPP Tiranë godinën ku ndodhet pasuria objekt verifikimi.

31.4. Sipas subjektit, pavarësisht se në kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, është shënuar se në datën e lidhjes së saj është kryer pagesa prej 4.100.000 lekësh, kjo pagesë nuk është kryer. Subjekti pretendoi se sipas shpjegimeve të të atit, ky formulim në kontratë është bërë me qëllim marrjen e kredisë bankare, e cila ka qenë një kusht nga banka.

31.5. Sa i takon apartamenteve në rrugën “{\*\*\*}”, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me familjarët e tij, subjekti pretendoi se ato pasi janë shkëmbyer *de facto* me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, i janë shitur prej kësaj të fundit çiftit R. B. dhe A. Ç., si dhe z. Xh. A. (d.m.th., shoqëria ua ka kaluar në posedim dy shtetasve të tjerë dhe ka arkëtuar prej tyre vlerën e plotë të apartamenteve), fakt ky, sipas tij, i provuar sipas akteve të dorëzuara në Komision gjatë hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se, pavarësisht se deklarata noteriale e shkëmbimit të apartamenteve me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK është e nëntorit të vitit 2002, veprimi i shkëmbimit të pasurive mes palëve ka ndodhur më parë, fakt që provohet edhe nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, ndër to dhe ato të cilat lidhen me vendbanimin e deklaruar të z. R. B. në zyrën e gjendjes civile. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se, edhe pse kontrata apo mënyra se si kanë përfituar apartamentet këta shtetas mund të ketë probleme juridiko-civile, kjo, sipas tij, ka qenë rrjedhojë e mënyrës së të vepruarit nga “{\*\*\*}” ShPK, të cilën, sipas subjektit, edhe Komisioni e ka pranuar si të njohur botërisht.

31.6. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar në deklaratën *vetting* çdo fakt që dinte për marrëdhënien e krijuar me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, nga e cila ka origjinën pasuria objekt kontrolli, dhe se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, ai ka pasur për qëllim tregimin e çdo fakti të njohur me qëllim lehtësimin e Komisionit në verifikimin e mënyrës së përfitimit dhe burimit real të krijimit të kësaj pasurie. Subjekti pretendoi se nuk mund të mbajë përgjegjësi për

shkak të mosinformimit nga babai dhe të neglizhencës së treguar nga ky i fundit, në lidhje me të gjitha veprimet e kryera për shkëmbimin e këtyre pasurive.

32. Në parashtrimet shtesë me shkrim lidhur me ankimin, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.02.2025, sa i takon pasurisë objekt kontrolli, ai shprehet se, veç qëndrimit të mbajtur në ankim dhe provave të depozituara në Komision, të cilat, sipas tij, vërtetojnë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasure dhe vlerën e saktë të saj, në saje të përpjekjeve të vazhdueshme, ka arritur të kontaktojë me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Kjo shoqëri, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 15.04.2024, të përfaqësuesit ligjor të administratores së kësaj shoqërie V. H., i është përgjigjur kërkesës së z. F. A. për përcjellje informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000. Subjekti pretendoi se informohet nga kjo shkresë se, nga verifikimet e kryera në arkivin e kësaj shoqërie, ka rezultuar se për këtë kontratë, është paguar nga shtetasi F. A. vetëm kredia që ai ka marrë nga banka në shumën 2.500.000 lekë dhe se formulimi i nenit 3 të kësaj kontrate, sipas kësaj shkrese, është bërë me qëllim marrjen e kredisë nga banka. Subjekti pretendoi se nga kjo shoqëri i është vënë në dispozicion edhe një vërtetim i datës 03.03.2014, i administratores së saj, në të cilin, sipas subjektit të rivlerësimit, provohet fakti se kontrata e sipërmarrjes e lidhur në vitin 2000 mes babait të tij dhe kësaj shoqërie është anuluar verbalisht dhe se palët kanë bërë një marrëveshje të re, sipas deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.11.2002, në të cilën është deklaruar edhe shuma e paguar dhe se, veç kësaj shume, z. F. A. nuk ka kryer pagesa të tjera. Subjekti pretendoi se informacioni i marrë nga kjo shoqëri konfirmohet edhe nga babai i tij, z. F. A., nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2022, të dorëzuar bashkëlidhur ankimit, në të cilën ky i fundit shpjegon, sipas subjektit, se shuma prej 4.100.000 lekësh nuk është paguar për shkak se kjo kontratë nuk është zbatuar, sepse apartamenti i porositur i ishte shitur nga sipërmarrësi, shtetasit M. Z..
33. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu parashtrroi se, në konfirmim të sa është pretenduar në ankim se mandati i arkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 16.11.2002, sipas të cilit z. Xh. A. i ka paguar administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. Rr. H., shumën prej 18.000 USD për blerjen e apartamentit të z. F. A., me sipërfaqe 43 m<sup>2</sup>, vlerësuar në raport edhe me sipërfaqen e apartamentit të blerë nga shtetasit R. B.dhe A. C. prej 116 m<sup>2</sup>, provojnë faktin se shtesa pa leje e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}” është kryer përpara se të ndodhte shkëmbimi i apartamenteve. Në funksion të të provuarit të këtij pretendimi, ai ka depozituar në Kolegj një akt ekspertimi teknik, datë 07.10.2024, të përgatitur nga inxhinierja gjeodete E. L., i cili, sipas tij, duhet të vlerësohet i lidhur me aktverifikimin e datës 20.05.2022, dorëzuar më parë në Komision, në të cilin është përcaktuar ndër të tjera planimetria aktuale e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, me të dyja shtesat e kryera, me dhe pa leje ndërtimi, ku sipërfaqja totale pretendohet se është 159 m<sup>2</sup>. Gjithashtu ka depozituar edhe aktet: (i) vërtetim i datës 03.03.2014, i administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, znj. V. H., shoqëruar me ekstraktin e regjistrimit tregtar të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; dhe (ii) shkresë kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 15.04.2024, e përfaqësuesit me prokurë të përgjithshme të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e shoqëruar nga prokura e përgjithshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.10.2021, e shoqërisë

“{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga administratorja V. H., dhe ekstrakti i regjistrit tregtar për studion ligjore “{\*\*\*}”, për të cilat, pasi pretendoi se kanë qenë të pamundura të siguroheshin më parë prej tij për shkak kontaktimi pasi korrespondenca me administratoren dhe përfaqësuesit e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për shkak të problemeve që ka kjo shoqëri me organet e zbatimit të ligjit, ka qenë e pamundur, kërkoi që të administrohen nga Kolegji si prova të reja në proces.

34. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vlerësoi të marrë në analizë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato gjatë procesit të zhvilluar në Komision, lidhur me mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, duke i analizuar ato në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, sa kohë konstatoi se konkluzioni i këtij të fundit mbi këtë pasuri, bazohet kryesisht në arsyetimin mbi deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit dhe dyshimet e Komisionit lidhur me ekzistencën e marrëdhënies së shkëmbimit të pasurive mes familjes Abdiu dhe shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

➤ *Lidhur me marrëdhënien e pretenduar të shkëmbimit të pasurive mes familjes Abdiu dhe shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK:*

35. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, me adresë: Njësia Bashkiake numër 7, rruga “{\*\*\*}”, ndërtesa {\*\*\*}, hyrja {\*\*\*}, apartamenti {\*\*\*}. I krijuar në datën 19.11.2002 , ndërsa si burim për krijimin e kësaj pasurie, ka deklaruar shkëmbimin e dy apartamenteve në rrugën “{\*\*\*}”, të cilat janë në bashkëpronësi të tij në 3/10 pjesë<sup>15</sup> me 2 apartamente me hyrje më vete, me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, kulla nr. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, sot rruga “{\*\*\*}”, ndërtesa {\*\*\*}, hyrja {\*\*\*}, Tiranë, sipas deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.11.2002 midis deklaruesve F., K., Altin, R. Abdiu dhe Rr. H., administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Ndërsa në deklaratën e interesave private periodikë për herë të parë, dorëzuar në ILDKPKI në mars të vitit 2004, trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi: (sasia në natyrë) 90 m<sup>2</sup>, vleftha në milionë lekë: 4, pjesa që zotëron: 100%, vendndodhja: rr. “{\*\*\*}” nr. {\*\*\*}, para gjykatës, s’ka regjistrim. Burimi: Nga këmbimi i dy apartamenteve në rr. “{\*\*\*}”, p. {\*\*\*} dhe nga pjesëtimi vullnetar.**
36. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* dhe në mbështetje të deklaratimeve të dhëna lidhur me krijimin e pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit, në zbatim të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar edhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.11.2002, të dhënë para noteres A. N. nga F., K., Altin e R. Abdiu dhe Rr. H.. Sipas kësaj deklarate, sikundër konstatuar edhe nga Komisioni në vendim, deklaruesit rezultojnë të kenë shprehur dakordësinë e tyre për të shkëmbyer apartamentin në bashkëpronësi të familjarëve Abdiu që ndodhet në rrugën “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, me dy hyrje më vete, të regjistruar në ZRPP Tiranë, me dy

---

<sup>15</sup> Pasuria rezulton e regjistruar në AShK në bashkëpronësi të F. A. (babai i subjektit) me 3/10 pjesë, K. A. (e ëma e subjektit) me 3/10 pjesë, Altin Abdiu me 3/10 dhe R. A. (e motra e subjektit) me 1/10 pjesë.

apartamente që ndodhen po në Tiranë, në rrugën “{\*\*\*}”, kulla nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, pronë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Palët kanë rënë dakord që kontrata e shkëmbimit të pasurive të përpilohet pas regjistrimit të pallatit të kësaj shoqërie në ZRPP Tiranë. Në po të njëjtën datë, konstatohet të jetë bërë një deklaratë për pjesëtim vullnetar mes familjarëve Abdiu të pasurive të deklaruara si të përfituara nga shkëmbimi i apartamentit të banimit në rrugën “{\*\*\*}” me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Trupi gjykues vëren se, sipas kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka marrë në posedim apartamentin me sip. 90 m<sup>2</sup>, ndërsa apartamenti tjetër me sip. të përgjithshme 110 m<sup>2</sup> është lënë në “bashkëpronësi” të prindërve dhe motrës së subjektit të rivlerësimit.

37. Në kushtet kur babai i subjektit të rivlerësimit, z. F. A., për shkak të detyrës së tij, rezulton të ketë qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në kuadër të konstatimit të drejtë dhe në mënyrë të plotë të situatës faktike lidhur me krijimin e pasurisë objekt kontrolli, duke qenë z. F. A. i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimet me këtë pasuri, trupi gjykues çmoi të nevojshme të marrë në analizë edhe deklaratimet e kryera prej tij lidhur me këtë pasuri. Nga verifikimi i deklaratimeve të këtij të fundit, trupi gjykues konstatoi se babai i subjektit të rivlerësimit në deklaratën për herë të parë të dorëzuar në ILDKPKI më datë 10.03.2004, lidhur me apartamentet e përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ka deklaruar: apartament, (sasia në natyrë) 95 m<sup>2</sup>, vlefte në milionë lekë: 4, pjesa që zotëron 50% – *është ndërruar në fillim të vitit 2003 me dy apartamente të tjera më të vogla. Pas pjesëtimit vullnetar të tyre, disponoj së bashku me gruan vetëm sipërfaqen e lartpërmendur.* Në rubrikën e burimit, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *Ky apartament së bashku me apartamentin që disponon djali Altini, janë këmbyer me dy apartamente që kishim në rrugën “{\*\*\*}”, pall. {\*\*\*}, shkalla e dytë. Diferenca e sipërfaqes së tyre është likuiduar me një kredi dhe me kursimet tona nga pagat.* Në këtë deklaratë, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si gjendje familjare veten, bashkëshorten dhe vajzën e tyre R. A., ndërkohë në rubrikën e likuiditeteve ka deklaruar të holla, vlera 2,5 milionë lekë, me vendndodhje në banesë, dhe burim *kursimet e realizuara nga pagat e mia dhe të djalit deri në vitin 2002.*
38. Gjatë hetimit administrativ në Komision, referuar informacionit të përcjellë nga Banka Raiffeisen me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.09.2022, kjo e fundit informon Komisionin, ndër të tjera, se në emër të z. F. A. është disbursuar një kredi sipas kontratës së huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2001, në shumën 2.500.000 lekë, e cila në datën 18.04.2001, ka kaluar në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, sipas urdhërtransfertës përkatëse. Banka Raiffeisen informon gjithashtu se kjo kredi ka pasur për objekt financimi pronën “apartament në Blv. “{\*\*\*}”, e ndodhur në një godinë në ndërtim”, dhe për të cilën babai i subjektit të rivlerësimit ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Banka Raiffeisen është shprehur gjithashtu se: *në kushtet kur apartamenti i financiar nuk është i regjistruar në ZVRPP dhe derisa ky proces të përfundojë, banka e ka siguruar kredinë e dhënë nëpërmjet vendosjes si kolateral të pasurisë në pronësi të familjes Abdiu në rrugën*

“{\*\*\*}”. Për këtë qëllim, rezultoi të jetë lidhur edhe kontrata për vendosjen e hipotekës në favor të bankës mbi apartamentin në rrugën “{\*\*\*}” me sipërfaqe totale prej 114,3 m<sup>2</sup>.

38.1. Trupi gjykues konstatoi se bashkëlidhur shkresës së sipërcituar të Bankës Raiffeisen, ishte përcjellë edhe kontrata e sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2000, e lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. F. A. në cilësinë e porositësit. Sipas kësaj kontrate, sipërmarrësi ka marrë përsipër të ndërtojë për porositësin në pallatin në adresën: blv. “{\*\*\*}”, apartamentin me nr. {\*\*\*}, me sip. 111 m<sup>2</sup>, në shkallën {\*\*\*}, kulla nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, vlera e tij është përcaktuar në shumën 44.400 USD, e konvertuar në 6.660.000 lekë. Referuar nenit 3 të kontratës, *pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhet duke likuiduar vleftën prej 2.500.000 lekësh me kredinë e dhënë nga Banka e Kursimeve [...]. Diferenca është likuiduar nga porositësi me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.*

39. Gjatë hetimit administrativ në Komision subjekti i rivlerësimit, në kuadër të pyetësorëve të përcjellë nga Komisioni, ka dhënë shpjegime e depozituar dokumentacion nga ku rezultoi, ndër të tjera, si më poshtë:

39.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti është përgjigjur: *Për sa i përket kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, unë subjekti i rivlerësimit nuk kam qenë në dijeni të ekzistencës së kësaj kontrate. Jam vënë në dijeni rreth 6 muaj më parë [...]. Nga biseda që kam zhvilluar me babain F. A., ai më ka shpjeguar se, me sa mban mend, kontrata e mësipërme e sipërmarrjes është grisur, pasi ajo është anuluar sepse administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Rr. H., këtë apartament ia kishte shitur një personi tjetër. Në këto kushte, midis babait dhe administratorit Rr. H. është rënë dakord që shuma e paguar, prej 2.500.000 lekësh, nga babai për kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, do të përdorej për të realizuar shkëmbimin e dy apartamenteve në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}”, të evidentuara në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.11.2002, me pasurinë që unë dhe familjarët e mi kishim në rrugën “{\*\*\*}”. [...] Pasuria në rrugën “{\*\*\*}” rezulton aktualisht e regjistruar në emër të familjarëve të mi dhe timin, për shkakun se deri në këto momente nuk është realizuar kontrata e shkëmbimit të pasurive sepse ende pasuria e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK e shkëmbyer, faktikisht nuk është regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për shkak të problematikave të kësaj shoqërie dhe administratorëve të saj me ligjin. Sipas informacioneve që kam, pasuria në rrugën “{\*\*\*}” përdoret nga dy familje sipas marrëveshjeve që ata kanë bërë me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, e cila rezulton poseduese e kësaj pasurie<sup>16</sup>.*

39.2. Në vijim të përgjigjeve të dhëna për këtë pyetësor, në plotësim të përgjigjes nr. 1/a, lidhur me kontratën e sipërmarrjes të lidhur për porositjen prej babait të tij, të një apartamenti nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, subjekti i rivlerësimit<sup>17</sup> është shprehur se ka arritur të sigurojë dokumentin “Kontratë sipërmarrje” nr. {\*\*\*} rep./kol., të datës 08.02.2001, e cila lidhet me

<sup>16</sup> Shih përgjigjet e pyetjeve 1/a, 1/c, 1/c.1 të pyetësorit nr. 3 të Komisionit.

<sup>17</sup> Në e-mail-in e dërguar Komisionit në datën 28.03.2022.

apartamentin e porositur fillimisht prej babait të tij dhe një deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 25.03.2022, akte të cilat i ka përcjellë bashkëlidhur. Nga shqyrtimi i këtyre akteve, trupi gjykues vëren se:

(i) Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 08.02.2001, të lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. M. Z. në cilësinë e porositësit, rezulton se shoqëria sipërmarrëse ka marrë përsipër të ndërtojë për porositësin, në pallatin në bulevardin {\*\*\*}”, një apartament me sipërfaqe totale prej 222 m<sup>2</sup>, i përbërë nga 2 apartamente 2+1, secili me nga 111 m<sup>2</sup>, përkatësisht në katin {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të banimit në kullën me nr. {\*\*\*}, me nr. apartamentesh {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, ku apartamenti i identifikuar me nr. 34 dhe të dhëna si më sipër, konstatohet për nga përshkrimi i njëjtë me apartamentin objekt i kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, i lidhur nga babai i subjektit dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Referuar nenit 2 të kësaj kontrate, vlera e apartamentit së bashku me dy garazhet është përcaktuar në shumën 100.360 USD.

(ii) Nga shqyrtimi i deklaratës e noteriale nr. {\*\*\*}, datë 25.03.2022, të dhënë nga z. M. Z., trupi gjykues konstaton se ky i fundit konfirmon sa referuar në kontratën e mësipërme të sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe, ndër të tjera, deklaron se: *Që nga koha që kam bërë kontratën e porosisë/sipërmarrjes, kam poseduar atë apartament pa pasur asnjë shqetësim, pavarësisht se shoqëria e ndërtimit nuk na ka siguruar akoma pronësinë e tyre.* Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se në fashikullin e çështjes, janë administruar edhe kopje të librezave të lëshuara në funksion të kontratave për shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike në emër të M. Z. për apartamentin nr. {\*\*\*}, në katin e {\*\*\*}, në rrugën “{\*\*\*}”.

**39.3.** Subjekti i rivlerësimit në vijim ka dorëzuar në Komision<sup>18</sup> një kontratë sipërmarrjeje me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 22.11.2001, të lidhur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e përfaqësuar nga administratori Rr. H., në cilësinë e sipërmarrësit dhe R. B. dhe A. Ç. në cilësinë e porositësit. Sipas nenit 1 të kësaj kontrate: *Shoqëria merr përsipër të ndërtojë në pallatin që ndodhet në rr. “{\*\*\*}”, një apartament me sipërfaqe 135, në katin {\*\*\*}, i përbërë nga 2+1 dhe ambiente të tjera ndihmëse, përkundrejt çmimit të përcaktuar në nenin 2 të saj, prej 46.800 USD.* Trupi gjykues konstatoi se kontrata shoqërohej me dy mandatarkëtime të datave 26.11.2001 dhe 27.11.2001, ku në brendësi të mandatit të datës 26.11.2001, shënohet se dy porositësit i kanë arkëtuar shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK shumën 6.505.000 lekë = 46.400 USD për blerjen e apartamentit 2+1, me sipërfaqe 135 metra katrorë, tek ap. i F. A. për llogari të firmës “{\*\*\*}”. Mandati rezultoi të jetë nënshkruar nga Rr. H. dhe R. B.. Disa ditë më vonë rezultoi të jetë shlyer edhe diferenca e

---

<sup>18</sup> Njëpërmjet komunikimit të datës 29.04.2022 me Komisionin, subjekti i rivlerësimit është shprehur: [...] jam i detyruar të paraqes plotësimet në lidhje me pyetjen nr. 1 të pyetësorit nr. 3, pasi sot në datë 29.04.2022 arrita të siguroj “Kontratë sipërmarrjeje” nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 22.11.2001, të cilën e vlerësoj si një dokument të rëndësishëm justifikues ligjor në lidhje me procesin e rivlerësimit. Kjo kontratë sipërmarrjeje ka të bëjë me apartamentin e shkëmbyer në rrugën “{\*\*\*}”, të regjistruar në hipotekë në adresën [...] i cili figuron në pronësi të familjes Abdiu.

mbetur prej 400 USD, sipas mandatit të datës 27.11.2001, me përshkrimin “Për likuidimin e apartamentit”, nënshkruar nga Rr. H..

39.4. Në prapësimet e tij ndaj rezultateve të hetimit të Komisionit, subjekti, ndër të tjera, rezultoi të ketë depozituar edhe:

a. Një deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.05.2022. Referuar këtij akti, znj. M. B. dhe Xh. A. kanë deklaruar: *Deklarojmë nën përgjegjësinë ligjore se: sipas mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 16.01.2002, unë Xh. A. i kam paguar Rr. H. në cilësinë e administratorit të firmës “{\*\*\*}” ShPK, shumën 18.000 USD për blerjen e “apartament 1+1 të z. F. A.” (siç është shënuar në mandatin e arkëtimit). Në këtë apartament, i cili ndodhet në rrugën “{\*\*\*}”, pall. {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë, që nga viti 2002 banon vajza ime M. Xh. B. së bashku me bashkëshortin e saj Xh. B. dhe dy fëmijët e tyre [...] bashkëngjitur deklaratës është mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 16.11.2002. Nga verifikimi i këtij mandatarkëtimi, trupi gjykues konstaton se në rubrikën lidhur me “përshkrimin e mandatarkëtimit”, shkruhet: *Blerje 1+1, te F. A.. Blerja është nga firma “{\*\*\*}” [...]. Në pjesën e sipërme të këtij mandati, është shënuar: Tapinë do ta marr nga firma “{\*\*\*}”.**

b. Një certifikatë familjare të z. R. B., nga ku konstatohet se në pjesën fundore të saj është bërë ky shënim nga Zyra e Gjendjes Civile: *Kjo certifikatë lëshohet për: Gjendje familjare datë 31.12.2009, ardhur nga njësia nr. {\*\*\*} pa adresë, nr. {\*\*\*}, dt. 31.05.2002, në Njësinë nr. 7, në adresën: pallati {\*\*\*}, shkalla {\*\*\*}, apartamenti nr. {\*\*\*}.*

40. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se apartamenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit në godinën e ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, i deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe objekt kontrolli sipas këtij shkaku ankimi, nuk është apartamenti objekt i kontratës së sipërmarrjes së lidhur mes së njëjtës shoqëri sipërmarrëse dhe babait të subjektit të rivlerësimit në nëntor të vitit 2000, pasi rezultoi si më sipër, se për këtë apartament është lidhur një tjetër kontratë sipërmarrjeje në shkurt të vitit 2001, mes po kësaj shoqërie dhe z. M. Z., i cili e posedon *de jure* këtë apartament, referuar edhe akteve të lëshuara nga operatorët e shërbimeve utilitare, të cilat, në raste të tilla, marrëdhëniet me klientët i krijojnë juridikisht mbi bazën e kontratave të sipërmarrjeve. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, e lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe babait të subjektit të rivlerësimit nuk është origjina e pasurisë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

41. Lidhur me apartamentet në pronësi të familjes Abdiu në rrugën “{\*\*\*}”, trupi gjykues, nga shqyrtimi i sa më sipër konstatuar nga analizimi i akteve të administruara në fashikullin e çështjes, vlerësoi se ato posedohen nga persona të tretë, të cilët këtë të drejtë e kanë përfituar nga një marrëdhënie e krijuar me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me pronarët e ligjshëm të kësaj pasurie, duke bërë objektivisht të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi një marrëdhënie shkëmbimi pasurish me këtë shoqëri, e cila provonte faktikisht dorëzimin e pasurive objekt shkëmbimi, pavarësisht mungesës së një procesverballi dorëzimi, si

evidentuar në vendim nga Komisioni. Ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni në lidhje me marrëdhënien e krijuar mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe R. B. A. Ç., trupi gjykues çmoi se pavarësisht se, si me të drejtë është konstatuar nga Komisioni, marrëdhënia mes palëve të mësipërme është formalizuar në kuadër të një kontrate porosie, mandatarkëtimet bashkëlidhur kontratës, të marra në analizë si më sipër, të cilat provojnë shlyerjen e çmimit të vendosur në kontratë referojnë në një marrëdhënie shitblerjeje pasurie. Kjo mospërputhje, pasi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues dhe u çmua në raport me tërësinë e fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, u vlerësua se nuk është tregues i një mandatarkëtimi fiktiv, por përkundrazi, rezultat i një situatë komplekse në këtë transaksion tjetërsimi të pasurisë, ku kontrata e sipërmarrjes ka shërbyer si një mekanizëm garancie për blerësin, në kushtet kur shitësi nuk kishte fituar *de jure* titullin e pronësisë mbi apartamentin objekt transaksioni, për të proceduar me një kontratë shitblerjeje.

42. Konstatimi/konkluzioni tjetër i Komisionit se pasuria objekt shkëmbimi (pasuria e familjes Abdiu), ishte vendosur si kolateral për sigurim kredie dhe, si e tillë, ajo nuk mund të tjetërsohej deri në shlyerjen e kësaj kredie në vitin 2012, nuk u gjet i bazuar nga trupi gjykues në drejtim të vlerësimit të këtij fakti, si pengesë për marrëdhënien e shkëmbimit, pasi, bazuar në sa referuar më sipër, vetë banka kredidhënëse kishte pranuar se sigurimi i kredisë me hipotekë të vendosur mbi pasurinë e familjes Abdiu në rrugën “{\*\*\*}” ishte rrjedhojë e faktit të gjendjes në ndërtim të objektit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe kjo situatë do të vazhdonte deri në regjistrimin e objektit, moment kohor ky që do të përkonte me lidhjen e kontratës së shkëmbimit.
43. Në përfundim të kësaj analize, ndonëse është fakt se shkëmbimi *de jure* i pasurive mes familjes Abdiu dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nëpërmjet lidhjes së kontratës së shkëmbimit të këtyre pasurive dhe regjistrimit të titujve përkatës të pronësisë sipas kërkesave të Kodit Civil nuk kishte ndodhur dhe ky fakt ishte objektivisht i justifikuar, për sa kohë gjatë hetimit u provua se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk e kishte regjistruar ende objektin e ndërtuar në AShK, trupi gjykues, bazuar në situatën faktike të konstatuar dhe të analizuar si më sipër në këtë vendim, krijoi bindjen se marrëdhënia e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për shkëmbimin e pasurive mes familjes së tij dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, kishte ndodhur *de facto* dhe është pikërisht kjo marrëdhënie fakti e cila ka shërbyer si origjinë e pasurisë objekt kontrolli.

➤ *Në lidhje me përcaktimin e vlerës së pasurisë objekt kontrolli:*

44. Lidhur me përcaktimin e vlerës së pasurisë objekt kontrolli, në kuptim të vlerës së investuar nga familja Abdiu për përfitimin e saj, në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, pavarësisht faktit se në kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, është shënuar se në datën e lidhjes së saj është kryer pagesa prej 4.100.000 lekësh, kjo pagesë nuk është kryer dhe se ky formulim në kontratë është bërë me qëllim marrjen prej të atit të kredisë bankare, e cila ka qenë një kusht nga banka, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se pjesë e praktikës shkresore të kredisë së marrë pranë Bankës Raiffeisen nga babai i subjektit të rivlerësimit, rezultoi të jenë edhe disa kontrata të tjera, të depozituara në bankë

nga babai i subjektit, z. F. A., në kuadër të aplikimit të pasuksesshëm për kredi për blerje apartamenti, në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

45. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni shkresor, trupi gjykues konstatoi se:

45.1. Sipas kontratës noteriale të shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.12.1999, të lidhur mes babait të subjektit në cilësinë e blerësit dhe z. B. R., ishte rënë dakord për shitblerjen e një shtëpie banimi në rrugën “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Tiranë, kundrejt çmimit prej 5.000.000 lekësh, shumë e cila referohej se ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale.

45.2. Sipas një tjetër kontratë të lidhur mes të njëjtave palë, në të njëjtën datë dhe me të njëjtat kredenciale të aktit të sipërcituar noterial, me objekt shitblerjen e së njëjtës pasuri të paluajtshme, çmimi i shitblerjes përcaktohej në të njëjtën vlerë prej 5.000.000 lekësh, por ndryshe nga kontrata e mësipërme, shuma prej 2,5 milionë lekësh përcaktohej e likuiduar në momentin e përpilimit të kontratës, ndërsa pjesa e mbetur prej 2,5 milionë lekësh do të likuidohej nga kredia që do të merrte blerësi nëpërmjet Bankës së Kursimeve Tiranë.

45.3. Në vijim, në vitin 2000, trupi gjykues konstatoi se ishte depozituar pranë së njëjtës bankë një tjetër kontratë shitblerjeje me nr. {\*\*\*} prot., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.03.2000, e lidhur mes të njëjtave palë si më sipër cituar, për blerjen e së njëjtës pasuri dhe me parashikim identik lidhur me çmimin dhe mënyrën e pagesës, si: “Këtë pronë shitësi ia shet blerësit kundrejt një çmimi prej 5.000.000 lekësh. Nga kjo shumë, 2,5 milionë lekë u likuiduan në momentin e përpilimit të kësaj kontrate, ndërsa 2,5 milionë lekë do të likuidohen nga kredia që do të marrë blerësi nëpërmjet Bankës së Kursimeve Tiranë”.

46. Në analizë të sa më sipër, mbi aplikimet e babait të subjektit të rivlerësimit për marrje kredie pranë Bankës së Kursimeve me kontrata të ndryshme noteriale, të lidhura brenda një harku të shkurtër kohor, me përcaktime konkrete, të ngjashme, për pagesa të shlyera në momentin e lidhjes së kontratës, si në atë të kontratës së sipërmarrjes objekt kontrolli nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, trupi gjykues krijoi bindjen se ndodhemi para një rasti të kontratave që dëshmojnë për transaksione jo të vërteta, me qëllim realizimin e marrjes së kredisë dhe se pagesat e parashikuara në to brenda këtij harku të shkurtër kohor, nuk janë kryer realisht. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti bindës pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 4.100.000 lekësh nuk i është paguar shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK sipas kontratës së sipërcituar të sipërmarrjes, por ajo ka qenë në funksion të kredisë bankare që realisht u mor nga babai i subjektit të rivlerësimit në muajin prill të vitit 2001.

47. Ky konkluzion u bazua edhe në arsyetimin e trupit gjykues si më sipër në vendim, se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë

20.11.2000, nuk ka shërbyer si origjinë e pasurisë objekt kontrolli, origjina e vërtetë e së cilës ka qenë marrëdhënia e shkëmbimit të pasurive me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.

48. Fakti i konstatuar gjatë hetimit administrativ mbi pagesën e shumës prej 2.500.000 lekësh në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nëpërmjet kredisë së lëvruar në funksion të kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, u mor në analizë nga trupi gjykues dhe u çmua në kontekst të marrëdhënies së shkëmbimit me shoqërinë e sipërcituar, duke mbajtur njëkohësisht në konsideratë deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën për herë të parë, ku ky i fundit ka deklaruar pasurinë objekt kontrolli si të fituar nga shkëmbimi i dy apartamenteve, njëkohësisht duke deklaruar në rubrikën e vlerës shumën 4 milionë lekë. Ky deklarin i subjektit të rivlerësimit si më i afërti në raport me kohën e krijimit të pasurisë objekt kontrolli dhe me vlerë prove në procesin e rivlerësimit kalimtar, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të një vendimmarrjeje të drejtë dhe objektive, u çmua nga trupi gjykues se duhet të analizohet në harmoni me deklarin e babait të subjektit të rivlerësimit në deklaratën për herë të parë, si subjekt deklarues më vete para ILDKPKI-së, se: *Ky apartament së bashku me apartamentin që disponon djali im Altini janë këmbyer me dy apartamente që kishim në rrugën “{\*\*\*}”, pallati nr. {\*\*\*}, shkalla nr. {\*\*\*}. Diferenca e sipërfaqes së tyre, likuiduar me një kredi dhe me kursimet tona nga pagat. Ky deklarin i cili përputhet me deklarin e subjektit për sa i takon mënyrës së përfitimit të pasurisë, rezulton të jetë më i plotë dhe sqarues në drejtim të deklarin prej tyre të shumës 4 milionë lekë në rubrikën që i përket vlerës së pasurisë së deklaruar, e cila duket të jetë vlera monetare e investuar për transaksionin e shkëmbimit të pasurive me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Vlerë kjo e cila, çmuar edhe në raport me vlerën e dy pasurive në rrugën “{\*\*\*}”, pjesë e marrëveshjes së shkëmbimit, vlerësohet nga trupi gjykues e balancuar për palët, krahasuar me skenarin alternativ të Komisionit të pagesës së një shume prej 6.600.000 lekësh shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas kontratës së sipërmarrjes së vitit 2000 dhe shkëmbimit të dy apartamenteve në rrugën “{\*\*\*}”, transaksion ky që vlerësohet në disproporcion me vlerën e apartamenteve të përfituara në shkëmbim nga familja Abdiu.*
49. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues çmoi të verifikojë mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli sipas vlerës së pasurisë dhe burimeve të deklaruara nga babai i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e këtij të fundit të dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2004. Në kuptim të sa më sipër, nga analizimi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes së subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992-2003, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit deri në dhjetor të vitit 2002<sup>19</sup>, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij rezultuan me burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kryer për apartamentin objekt kontrolli, në vlerën e 4.000.000 lekëve.
50. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka pasur dijeni për pagimin e shumës 2.500.000 lekë nga babai i tij dhe menjëherë sapo ka ardhur në dijeni të këtij fakti, e ka deklaruar

---

<sup>19</sup> Referoju deklaratës për herë të parë të dorëzuar në ILDKPKI më datë 10.03.2004 nga babai i subjektit të rivlerësimit, mbi kursimet e krijuara së bashku me djalin deri në vitin 2002.

atë gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni dhe se ky pretendim i tij mbështetet edhe nga deklarimi i kryer në deklaratën për herë të parë në ILDKPKI, i cili është i ndryshëm nga ai i babait të tij, trupi gjykues, teksa konstaton të bazuar pretendimin mbi diferencën në deklarimet e tyre sa u takon burimeve të kësaj pasurie, konstaton gjithashtu se deklarimi i subjektit në deklaratën për herë të parë, përputhet sa i takon vlerës së pasurisë me deklarimin e babait të tij, z. F. A., e cila rezulton të jetë deklaruar prej të dyve në shumën 4 milionë lekë. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit, i ndodhur para detyrimit kushtetues dhe ligjor për të deklaruar me saktësi dhe plotësi pasuritë e tij, duhet të kishte treguar kujdes në verifikimin paraprak se çfarë burimesh ishin përdorur për krijimin e kësaj shume të deklaruar si të investuar edhe prej vetë atij në deklarimin për herë të parë, edhe pse pagesat ishin kryer nga babai i tij dhe jo nga subjekti personalisht.

51. Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, në Njësinë Bashkiake nr. 7, Tiranë, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të saktësisë së deklarimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e saj, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
52. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së paluajtshme shtëpi dykatëshe (një kat plus papafingo), e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Kavajë, te kompleksi turistik “{\*\*\*}”, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
53. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka konkluduar gjithashtu se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime të ligjshme për krijimin e saj, duke vënë subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se [...] subjekti: (i) në vazhdimësi ka dhënë deklarime kontradiktore lidhur me periudhën dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie; (ii) ka ndryshuar burimet e deklaruara për krijimin e saj: (a) në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë; (b) në deklaratën e pasurisë vetting; dhe (c) në përgjigjet e dhëna Komisionit gjatë hetimit administrativ dhe në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit; si dhe se (iii) nga analiza financiare e kryer lidhur me verifikimin e mundësisë së personave të tjerë të lidhur, prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimet dhe shpenzimet e kryera deri në fund të vitit 2003 (përfshirë dhe pagesën e bërë për pasurinë objekt vlerësimi), si

*edhe investimet dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit 2005 (përfshirë dhe pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi).*

54. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit se ai ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe se personat e tjerë të lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj, duke vënë subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:

54.1. Pasaktësia në deklaram qëndron në deklarimin e kryer prej tij në deklaramen periodike të vitit 2004, në të cilën ka dashur të deklarojë faktin se i kanë dhënë shtetasit N. H., shumën 4.000.000 lekë për pjesën takuese për shtëpinë e ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, të ndodhur po në {\*\*\*} dhe jo për vilën te fshati “{\*\*\*}”. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo pasaktësi ka ndodhur për faktin se deklarata e periodike e vitit 2004 është dorëzuar në mars të vitit 2005, periudhë në të cilën, sipas tij, z. N. H. kishte kthyer shumën prej 4.000.000 lekësh, të cilën prindërit e subjektit e kishin përdorur për të paguar paraprakisht shumën e blerjes së banesës në shoqërinë “{\*\*\*}”. Subjekti pretendoi gjithashtu se pasaktësitë e kryera prej tij në deklarimet periodike të viteve 2003 dhe 2004, të cilat lidhen me pasuri të prindërve të tij dhe jo pasuri të vetë subjektit, nuk duhet të merren në konsideratë nga trupi gjyqësor, për sa kohë lidhur me këto pasuri, referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjekti nuk ka pasur detyrim deklarimi.

54.2. Pasuria objekt kontrolli, sipas këtij shkakui ankimi, ka vlerën 8.000.000 lekë dhe se ankuesi zotëron 1/3 pjesë të saj, me burim dhurimin nga prindërit, sikundër ka konstatuar edhe Komisioni, përderisa nuk ka dhënë asnjë kontribut financiar në krijimin e kësaj pasurie dhe se emri i tij si bashkëpronar në këtë pasuri vjen si rrjedhojë e dëshirës së prindërve të tij për ta përfshirë me tagra pronësie, si djalë i vetëm dhe madhor i familjes Abdiu. Subjekti pretendoi gjithashtu se nga provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, sipas tij, rezultoi se burimi i krijimit të pasurisë së paluajtshme në fshatin turistik “{\*\*\*}”, është nga kthimi i shumës 4.000.000 lekë të paguar shtetasit N. H. në vitin 2004, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga shitja e pjesës takuese që posedonte nëna e subjektit të rivlerësimit në pasurinë e porositur në vitin 2000 te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, kundrejt çmimit 40.000 USD.

54.3. Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>20</sup>, duhet ta kishte kufizuar hetimin dhe, rrjedhimisht, analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit, vetëm në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të përdorura për pjesën e pasurisë së dhuruar subjektit dhe jo të të gjitha pasurive të krijuara prej tyre.

54.4. Qëndrimi i Komisionit në analizën financiare të kryer prej tij për përllogaritjen e të dy apartamenteve në Golem, është i pabazuar, pasi as subjekti dhe as babai i tij nuk kanë deklaruar

---

<sup>20</sup> Subjekti referon vendimmarrjet e Kolegjit, të cilat u përkasin çështjeve të rivlerësimit të subjekteve D. Rreshka dhe I. Balli.

ndonjëherë në deklaratimet e tyre periodike para ILDKPKI-së, pronësinë apo të drejta reale lidhur me këto dy pasuri të paluajtshme njëkohësisht. Sipas subjektit, ndonëse Komisioni ka arsyetuar në vendim se pranon si prova deklaratat periodike të subjektit dhe të babait të tij, analiza financiare e kryer prej tij bie në kundërshtim me sa më sipër.

**54.5.** Pasuria e paluajtshme në fshatin turistik “{\*\*\*}”, të cilën kishin dashur ta blinin që në vitin 2002, është blerë në vitin 2005, sipas kontratës noteriale, duke shënuar edhe subjektin si bashkëpronar (si trashëgimtar i familjes). Lidhur me arsyen se përse vlera në kontratë është deklaruar 40.000 USD dhe jo në vlerën reale të saj, babai i subjektit ka dhënë shpjegime duke treguar se lidhja e kontratës së shitblerjes ka qenë formale dhe se çmimi real i saj ka qenë 8.000.000 lekë. Sipas subjektit, ky fakt tregon se ankuesi dhe i ati i tij kanë deklaruar atë çka ka ndodhur realisht se përndryshe do të kishin vendosur si vlerë të banesës atë që është shënuar në kontratë.

**54.6.** Referuar akteve të dorëzuara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision<sup>21</sup>, pasuria e paluajtshme e llojit shtëpi dykatëshe, e ndërtuar në {\*\*\*} me financues shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, përtej çdo dyshimi, është në pronësi të shtetasit N. H.. Subjekti pretendoi se e dhëna e shënuar në aktin e kolaudit, ku figuron e ëma e tij K. A. si financuese e ndërtimit të banesës së ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, është jorelevante dhe e pasaktë pasi investues i kësaj shtëpie, sipas dokumentacionit të administruar, është shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Subjekti, në përgjigje të qëndrimit të Komisionit se lidhur me këtë pasuri nuk ka një deklaratë për heqjen dorë nga K. A., ka paraqitur bashkëlidhur ankimit deklaratën noteriale të kësaj të fundit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2022.

**54.7.** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të prindërve të tij, në drejtim: (i) të vlerës së përlllogaritur nga Komisioni si të investuar për krijimin e pasurisë objekt kontrolli në fshatin turistik “{\*\*\*}” dhe asaj të paguar nga babai i tij shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për “apartamentet” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë; (ii) të mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve jetike të subjektit dhe prindërve të tij; (iii) të mospërfshirjes së pajustificuar në analizë financiare të të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit deri në fund të vitit 2002, periudhë gjatë së cilës ai pretendon që ka bashkëjetuar me prindërit e tij.

**55.** Në parashtrimet shtesë lidhur me ankimin, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.02.2025, sa i takon pasurisë objekt kontrolli, në vijim të kundërshtimeve në ankim lidhur me konkluzionet e Komisionit mbi dyshimet e këtij të fundit se pasuria e llojit vilë dykatëshe (pjesa takuese) e ndërtuar në {\*\*\*}, me financues/investitor shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, është në disponim dhe/apo posedim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit dhe se ai nuk arriti të provojë para

---

<sup>21</sup> *Librezë e ujit të shtetasit N. H. me nr. kontrate {\*\*\*}, si dhe disa mandate arkëtimi për vitet 2020 dhe 2022; librezë për furnizimin me energji elektrike në banesën e N. H. për kontratën {\*\*\*}, si dhe një mandat arkëtimi; vërtetim i lëshuar nga Njësia Administrative {\*\*\*} nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2022; deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 08.05.2022, e shtetasit S. Sh.*

Komisionit tej çdo dyshimi të arsyeshëm se këtë pasuri e posedon, disponon dhe gëzon vetëm shtetasi N. H., kjo për sa kohë nuk ka deklarim konkret për heqjen dorë nga të drejtat mbi këtë pasuri nga nëna e subjektit, ky i fundit shpjegon se, përveç kundërshtimeve të paraqitura në ankim, ka arritur të sigurojë edhe disa prova të reja nëpërmjet të cilave do të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të gjithë këtë pasuri e ka poseduar, gëzuar që nga data 17.10.2005, vetëm shtetasi N. H. dhe që nga data 24.07.2024, kjo pasuri rezulton e gjitha në pronësi të tij. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj edhe aktet shpresore të cilat kërkoi të merren si prova të reja në gjykim.

56. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, nga shqyrtimi i arsyesimit të Komisionit në vendim, konstatoi se qëndrimi i këtij të fundit për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë objekt kontrolli, bazohet në: (i) konstatimin e mospërputhjeve në deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarimet periodike dhe shpjegimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit në Komision sa i takon mënyrës së përfitimit të pasurisë objekt kontrolli, kohës dhe burimeve të krijimit të saj prej prindërve të tij; (ii) dyshimin e ngritur nga Komisioni se pasuria e paluajtshme “vilë dykatëshe” me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimi 214 m<sup>2</sup>, e ndodhur në bllokun e vilave në Golem, pranë “{\*\*\*}”, e ndërtuar në kuadër të kontratës së sipërmarrjes së lidhur në datën 27.10.2000, mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit dhe nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. K. A., dhe z. N. H. (i afërm i babait të subjektit), në cilësinë e porositësve, vijon të jetë ende në disponim/posedim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit, edhe pas shpjegimeve të dhëna dhe akteve provuese të depozituara në Komision, nuk arriti të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se këtë pasuri e disponon dhe gëzon vetëm z. N. H., duke e bazuar këtë konkluzion më së shumti në faktin e mungesës së një deklarimi nga ana e znj. K. A. për heqjen dorë nga kjo pasuri dhe, rrjedhimisht, pretendimet e subjektit se të ardhurat e krijuara nga shitja e pjesës takuese të kësaj vile nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Komisionit; (iii) rezultatin e analizës financiare të kryer nga ana e Komisionit, lidhur me vlerësimin e burimeve financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi i ka vlerësuar ata në cilësinë e *personave të tjerë të lidhur*, për sa kohë ka pranuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, për mosdhënie kontributi në blerjen e kësaj pasurie dhe se përfshirja e tij në cilësinë e bashkëpronarit me 1/3 pjesë takuese, vjen si pasojë e një marrëdhënieje dhurimi nga ana e prindërve. Kjo analizë ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie sipas vlerës së çmimit të plotë të saj, të përlloritur nga Komisioni në shumën e 12.133.200 lekëve<sup>22</sup>.
57. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi të analizojë këtë shkak të ankimit sipas pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, referuar konstatimeve të sipërcituara, mbi

---

<sup>22</sup> Referuar zërit “Vilë dykatëshe në fshatin “{\*\*\*}”, në tabelën nr. 1, në faqen 38 të vendimit të Komisionit.

bazën e të cilave Komisioni ka arritur në konkluzionin e tij përfundimtar mbi këtë pasuri. Më konkretisht:

➤ *Lidhur me saktësinë e deklaramit të kryer nga subjekti i rivlerësimit të pasurisë objekt kontrolli:*

58. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, vlerësimi i deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në deklaratat periodike vjetore para ILDKPKI-së, në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, si dhe në prapësimet e subjektit ndaj rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se situata faktike e konstatuar nga Komisioni në vendim<sup>23</sup>, sipas dinamikës së ngjarjeve, është e plotë dhe e saktë, gjithashtu e pakundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit. Bazuar në shqyrtimin e sa më sipër, vihet re se konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaramë kontradiktore lidhur me periudhën dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, si dhe ka ndryshime të burimeve të deklaruara për krijimin e saj nga prindërit e tij, në deklaratat periodike, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në përgjigjet e dhëna në Komision, është një konstatim i drejtë, i bazuar në fakte.
59. Vetë subjekti i rivlerësimit duket që e pranon këtë konstatim dhe pretendon se pasaktësia nga ana e tij, qëndron në deklaramin e kryer në deklaratën periodike të vitit 2004, në të cilën ka dashur të deklarojë faktin se i kanë dhënë shtetasit N. H., shumën 4.000.000 lekë për pjesën takuese për shtëpinë e ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, të ndodhur po në Golem dhe jo për vilën të fshati “{\*\*\*}”, dhe se arsyeja e kësaj pasaktësie ka ardhur për faktin se deklarata periodike e vitit 2004 është dorëzuar në mars të vitit 2005, periudhë në të cilën, sipas tij, z. N. H. kishte kthyer shumën prej 4.000.000 lekësh, të cilën prindërit e subjektit e kishin përdorur për të paguar paraprakisht shumën e blerjes së banesës në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.
60. Trupi gjykues vëren gjithashtu se Komisioni, referuar konkluzionit të arritur në paragrafët 36.15 dhe 36.16 të vendimit<sup>24</sup>, ka pranuar se vlera e paguar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit lidhur me 1/3 pjesë takuese në bashkëpronësi të subjektit me prindërit e tij, përbën dhurim nga këta të fundit në favor të subjektit. Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se si origjinë e kësaj pasurie për subjektin e rivlerësimit, ka shërbyer marrëdhëniet e dhurimit, ndërkohë që për dhuruesit, origjina e pasurisë objekt kontrolli rrjedh nga dinamika e fakteve dhe marrëdhënieve juridiko-civile të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* (për të cilat, si me të drejtë konstatuar nga Komisioni, janë vënë re mospërputhje në raport me aktet e administruara në fashikull gjatë hetimit).
61. Pavarësisht se në referim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 86/2016, në rastin e dhurimeve, subjektet e rivlerësimit nuk ngarkohen me detyrimin e deklaramit të burimeve të krijimit të pasurive nga personat e tjerë të lidhur (dhuruesit), por vetëm me detyrimin për të justifikuar në këtë proces, me të ardhura të ligjshme, pasuritë e dhuruara, dhe se, për rrjedhojë,

<sup>23</sup> Referoju paragrafëve nr. 36 – 36.6 dhe nr. 36.8 në faqet 24-29 dhe 30 të vendimit të Komisionit objekt ankimi.

<sup>24</sup> Shih faqen 31 të vendimit të Komisionit.

deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, kanë qenë me vullnetin e tij pa qenë ky para detyrimit ligjor për një deklaram të tillë, lidhur me fakte të cilat kanë ndodhur jo në prani të tij dhe që i përkasin mënyrës, kohës dhe burimeve të përdorura nga prindërit e tij në krijimin e pasurisë së “dhuruar”, të cilat janë konstatuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ si deklarime kontradiktore, trupi gjykues çmon se, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë mbi detyrimin kushtetues që mbartin subjektet e rivlerësimit në këtë proces, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për deklarimin saktësisht dhe plotësisht të pasurive të tyre dhe personave të lidhur, duhet të kishte marrë masat e nevojshme që deklarimet e dhëna në deklaratën e pasurisë *vetting*, qoftë dhe në mënyrë vullnetare, t’i kishte verifikuar paraprakisht.

➤ *Lidhur me periudhën e krijimit të pasurisë objekt kontrolli dhe vlerës së saj:*

62. Nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi, trupi gjykues konstaton se *Komisioni ka krijuar bindjen se pjesët takuese të pasurisë objekt kontrolli, vilës të “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Kavajë janë përfituar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit (familja Abdiu) së paku përpara deklarimit fillestar të pasurisë (deklaratë e bërë për pasurinë gjendje deri në fund të vitit 2003). Këtë konkluzion, Komisioni duket se e ka bazuar në deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në deklaratën noteriale të datës 29.7.2002, të depozituar bashkëlidhur saj, në deklaratën noteriale të datës 9.3.2022, të nënës së subjektit, znj. K. A., si dhe nga vlerësimi që u ka bërë deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, në cilësinë e subjekteve deklarues në ILDKPKI, ku, sipas Komisionit, është vlerësuar se prej tyre nuk është deklaruar se kanë zotëruar të drejta reale mbi pasurinë e llojit “vilë” dykatëshe, të përfituar nga marrëdhënia kontraktuale me subjektin “{\*\*\*}” ShPK, dhe as mbi shkëmbimin, shitjen apo pakësimin e kësaj pasurie. Referuar arsytimit të Komisionit në vendim, nga analizimi në harmoni i deklarimeve të bëra ndër vite, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, që nga deklarimi fillestar i pasurisë e deri në deklaratën periodike të vitit 2005, vit në të cilin është nënshkruar kontrata e shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, kanë deklaruar se disponojnë pjesë takuese vetëm mbi pasurinë vilë 2-katëshe, të ndodhur të fshati “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Kavajë. Bazuar në sa më sipër, Komisioni duket të ketë arritur në konkluzionin tjetër në drejtim të përlllogaritjes së vlerës së pasurisë se: *nisur nga deklarimet kontradiktore të bëra nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, deklarimeve të bëra mbi vlerën e saj, duke vlerësuar se deklaratat e interesave/privatë të depozituara ndër vite në ILDKPKI kanë fuqi të plotë provuese (kjo edhe në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016), si edhe bazuar në dokumentin shkresor provues, kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, çmohet përfundimisht se: (i) në vitin 2003, prindërit e subjektit kanë paguar 6/12 e vlerës prej 8.000.000 lekësh, vlerë e vetëdeklaruar e kësaj pasurie në deklaratat fillestare të pasurisë të vitit 2003; (ii) në vitin 2004, prindërit e subjektit kanë paguar shumën 4.000.000 lekë, deklaruar si e dhënë në favor të shtetasit N.H.; dhe (iii) në vitin 2005, prindërit e subjektit kanë paguar shumën 40.000 USD, pasqyruar si çmimi i blerjes së kësaj pasurie në kontratën përkatëse.**

63. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit si parashtruar më sipër në drejtim të vitit të krijimit të pasurisë objekt kontrolli dhe vlerës së saj të pretenduar prej 8.000.000 lekësh, nga analizimi i akteve të fashikullit të çështjes, çmuar ato edhe në funksion të arsyetimit të Komisionit si më sipër parashtruar, trupi gjykues vëren si vijon.
64. Në deklaratën e interesave privatë periodikë për herë të parë, dorëzuar në ILDKPKI në mars të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Vilë dy katëshe, (sasia në natyrë) 180 m<sup>2</sup>, (vlefata në milionë lekë) 8, pjesa që zotëron 2/12, vendndodhja fshati turistik {\*\*\*}, Kavajë, s'ka regjistrim. Burimi: Nga shitja e një apartamenti në bashkëpronësi në {\*\*\*}, Kavajë, dhe nga kursimet vjetore. Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Në fund të vitit 2004, unë dhe prindërit e mi, F. dhe K. A., i kemi blerë pa dokumente pronësie (pasi kjo pronë nuk është akoma e hipotekuar) kushëririt N. H., me banim në Durrës, 6/12 pjesë të vilës që kishim në bashkëpronësi me të në fshatin turistik “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Kavajë. Fshati turistik nuk është hipotekuar ende. Kjo pronë është blerë nga kursimet vjetore; dhe në rubrikën e vlerës së pasurisë, subjekti ka deklaruar: 4.000.000 lekë, me pjesë takuese 4/12 e gjithë banesës.*
65. Përveç deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore si më sipër, trupi gjykues vëren se babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e subjektit deklarues para ILDKPKI-së, ka dhënë deklaratimet e mëposhtme<sup>25</sup>.
- 65.1. Në deklaratën për herë të parë si subjekt deklarues, dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 22.04.2004, z. F. A. (babai i subjektit) ka deklaruar: *Vilë në bashkëpronësi (sasia në natyrë) 180 m<sup>2</sup>, (vlefata në milionë lekë) 8, (pjesa që zotëron) 17%, (vendndodhja) fshati turistik {\*\*\*}, nr. regjistri hipoteke s'ka. Kjo është ndërtesë dykatëshe. Njëri kat ose 6/12 është në pronësi të N. H., banues në Durrës. Njërin kat e kam në bashkëpronësi me gruan dhe djalin. Burimi: Kjo pjesë e kësaj vile e ka origjinën te një apartament që kishim në një pallat në {\*\*\*}, që është shitur. Veç vlerës së tij, diferenca nga të ardhurat në vitet 1992 deri 1999.*
- 65.2. Në deklaratën periodike për vitin 2004, z. F. A. ka deklaruar: *Në fund të vitit 2004, unë, bashkëshortja dhe djali Altini i kemi blerë kushëririt tim N. H., banues në Durrës, 6/12 pjesë të vilës që kishim në bashkëpronësi në {\*\*\*}, në fshatin “{\*\*\*}”. Fshati turistik është i pahipotekuar, prandaj blerja është pa dokumentacion ligjor. Është blerë me kursimet që kisha dhe me ato të vitit që kaloi. Shih për këtë formularin e vitit që kaloi nr. A-1 dhe A-5. Në rubrikën e vlerës në krah, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: 4.000.000 lekë; dhe pjesë takuese: zotëroj 2/12 e pjesës së blerë ose 4/12 e banesës.*
- 65.3. Në deklaratën periodike të vitit 2005, dorëzuar më datë 20.03.2006, z. F. A. ka deklaruar: *Banesa në {\*\*\*} për të cilën nuk kishte akt pronësie, është hipotekuar nga ZRP Kavajë, duke qenë*

<sup>25</sup> Referuar deklaratave periodike vjetore të përcjella për babain e subjektit të rivlerësimit, z. F. A., me anë të shkresës së ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 25.02.2022.

unë, K. e djali Altini bashkëpronarë. Në rubrikën e vlerës, është deklaruar shuma 8.000.000 lekë dhe pjesë takuese 4/12.

66. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, në zbatim të parashikimeve të nenit nr. 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kuadër të akteve justifikuese lidhur me deklaratimet e tij, sa më poshtë vijon:

(i) Kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.10.2000, e lidhur para noterit A. Z., mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit dhe znj. K. A. dhe z. N. H., në cilësinë e porositësve. Sipas kësaj kontrate, referuar nenit 1 të saj, porositësi kërkon nga sipërmarrësi ndërtimin e një vile dykatëshe me sipërfaqe ndërtimi 214 m<sup>2</sup>, e ndodhur në kompleksin e vilave që po ndërtohen në {\*\*\*}, e specifikuar me nr. {\*\*\*}, me planimetrinë që i bashkëngjitet, ku përfshihen: një dhomë ndenjjeje, dy dhoma gjumi, aneks gatimi, një banjë dhe një verandë për secilin kat. Referuar nenit 3 të kësaj kontrate, porositësi do të pranojë vilën e porositur dhe do të paguajë për të çmimin 50.000 USD, i cili, referuar nenit 5 të kontratës: *pagesa do të bëhet në sektorin e financës së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK kundrejt mandatit të arkëtimit.*

(ii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 29.07.2002, e dhënë para noteres A. N. nga deklaruesit K. A., N. H. dhe E. H., të cilët kanë deklaruar: *Unë, K. A. dhe N. H. kemi blerë një ndërtesë dykatëshe në {\*\*\*}, Kavajë, por nuk është e regjistruar akoma në ZRP Paluajtshme Kavajë. Jemi dakord që këtë ndërtesë dykatëshe ta shkëmbejmë me një ndërtesë po dykatëshe, që ndodhet në një fshat turistik, pronë e zotit E. H., i cili e ka të regjistruar pronën e tij në ZRP Paluajtshme Kavajë. Unë, E. H., jam dakord që të shkëmbej ndërtesën time dykatëshe me ndërtesën e znj. K. A. dhe z. N. H. Kontrata e shkëmbimit do të bëhet më vonë dhe kjo deklaratë ka fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit.*

(iii) Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.05.2005, lidhur para noteres M. Sh., mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga administratori E. H., në cilësinë e shitësit dhe F. A., K. A. dhe Altin Abdiu në cilësinë e blerësve. Sipas kësaj kontrate, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK u shet blerësve pasurinë e paluajtshme, ndërtesë dykatëshe (vilë), e ndodhur në zonën kadastrale nr. {\*\*\*}, në {\*\*\*}, Kavajë, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimore prej 93 m<sup>2</sup> (vetëm kati i parë) dhe sipërfaqe të truallit të objektit prej 750 m<sup>2</sup>, përkundrejt çmimit të shitjes prej 40.000 USD, shumë e cila është likuiduar prej blerësve në favor të shitësit, jashtë kësaj zyre.

67. Gjatë hetimit administrativ në Komision, janë administruar ndër të tjera edhe:

(i) Një shkresë e z. E. H.<sup>26</sup>, me anë të së cilës ky i fundit, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për dhënie informacioni lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së vitit 2005, si dhe të përcjelljes së çdo akti shkresor lidhur me shkëmbimin e pasurive sipas deklaratës noteriale të sipërcituar, ka informuar se: *Në datën 20.05.2005, unë si përfaqësues i shoqërisë u kam shitur një vilë që sa e përfundova shtetasve F., K. dhe Altin Abdiu [...]. Mënyra e pagesës është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pjesë-pjesë, duke i përdorur të hollat për ndërtimin*

---

<sup>26</sup> E protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 03.09.2022.

*e fshatit turistik që ka vazhduar me vite [...] Para asaj kohe, rreth viteve 2002, me sa e kujtoj, pa pasur ndonjë dokument, kemi përpiluar një deklaratë noteriale ku kemi qenë dakord që mund të këmbenim këtë vilë që ishte në ndërtim, me një banesë dykatëshe që kishin në bashkëpronësi si K. A. dhe një kushëri i quajtur N. H. nga Kosova. Pas kësaj, ata nuk u mirëkuptuan, sepse secila palë donte të zgjerohej për vete dhe të ndaheshin. Duke qenë kështu, më vunë në dijeni se atë banesë e mbajti N. në pronësinë e tij. Sipas thënieve të mëvonshme, mora dijeni se K. mori pjesën e saj dhe u largua nga ajo banesë. Pas asaj kohe, kanë blerë banesën që kanë në fshatin që ndërtoja unë. Për banesën që ishte në bashkëpronësi midis K. dhe N., me sa di unë, nuk kishte dokumentacion. Nga viti 2005, blerësit Abdiu banojnë në atë vilë. Banesa tjetër është afër fshatit tonë dhe në pronësi të N. H. që thonë se është në Zvicër.*

*(ii) Një deklaratë noteriale e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, e dhënë nga znj. K. A. para noteres E. Q., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.03.2022, sipas së cilës ajo deklaroi: Nga viti 2000, me kushëririn e bashkëshortit tim, shtetasin kosovar N. H., kemi blerë një banesë dykatëshe në një fshat turistik pranë “{\*\*\*}” në Golem. Pas një viti, kemi rënë dakord me bashkëpronarin që pjesën time takuese t’ia shes këtij të fundit kundrejt vlerës 40.000 dollarë amerikanë, pasi arrita një marrëveshje për të blerë një tjetër pasuri në Golem (te fshati turistik “{\*\*\*}”), të cilin e posedoj/disponoj aktualisht. Kjo shumë (çmimi i shitjes së pjesës takuese) është shlyer në dorë/cash, pasi nuk dispononim dokumentacion pronësie për pasurinë dhe ishim në pamundësi ligjore për të bërë transaksionin me bankë. Duke qenë se pasuria e blerë në bashkëpronësi me shtetasin N. H., nuk ishte regjistruar dhe pajisur me dokumente pronësie, sikurse sqarova dhe më sipër, pjesëtimi dhe shitja e pjesës takuese është bërë midis nesh palëve pa akte noteriale (pra, shitje faktike jo juridike). Me sa unë deklaruësja jam në dijeni, kjo ndërtesë/shtëpi banimi që prej asaj kohe dhe aktualisht posedohet nga shtetasi N. H. dhe ende nuk është realizuar regjistrimi dhe pajisja me dokumentacion pronësie për këtë pasuri.*

68. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren fillimisht se të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ nuk konvergojnë në lidhje me momentin specifik kohor kur është krijuar pasuria objekt kontrolli, me adresë në fshatin turistik “{\*\*\*}”. Pavarësisht kësaj, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni se deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij në deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI, nga deklarata për herë të parë e dorëzuar në vitin 2004 deri në atë periodike të vitit 2005, i referohen vetëm vilës së blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij para ILDKPKI-së, në periudhën e viteve 2003-2005, përfshijnë elemente të të dyja këtyre pasurive të paluajtshme, ndonëse deklaratimet e tyre janë konfuzë dhe të paqarta në drejtim të përcaktimit në mënyrë të qartë të raportit të të drejtave që ka pasur familja Abdiu me secilën prej këtyre dy pasurive të paluajtshme gjatë kësaj periudhe kohore. Konstatimet të cilat e çojnë trupin gjykues në arritjen e këtij përfundimi se arsyetimi i Komisionit si më sipër është i pabazuar, janë si vijojnë:

- Subjekti dhe babai i tij kanë deklaruar në deklaratën për herë të parë në ILDKPKI, të dorëzuar në vitin 2004, bashkëpronësinë e tyre në një vilë dykatëshe me z. N. H.. Referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në fashikullin e Komisionit, e vetmja pasuri e paluajtshme e cila lidh familjen Abdiu me z. N. H., është vila e porositur në fshatin turistik kufitar,

e ndodhur në të njëjtën zonë kadastrale nr. {\*\*\*}, në Golem, ajo e ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK. Ndonëse është fakt që as subjekti i rivlerësimit dhe as babai i tij nuk gëzonin *de jure* të drejta pronësie mbi këtë ndërtesë, duket se në këtë fazë ata kanë deklaruar të drejtat në pritje për t’u fituar si bashkëshorti dhe djali i znj. K. A., e cila rezultoi se së bashku me z. N. H. kishte lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.

▪ Ndër këto dy pasuri të paluajtshme të llojit “vila dy katëshe” me sipërfaqe pothuajse të njëjta, njëra pjesë e fshatit turistik të ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe tjetra pjesë e fshatit turistik të ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, vetëm kjo e fundit rezulton nga aktet e fashikullit të ketë qenë e paregjistruar në ZVRPP Kavajë, në periudhën e deklarimeve të kryera në deklaratat e viteve 2003-2005<sup>27</sup>, si rrjedhojë e faktit që fshati turistik nuk ishte ende i regjistruar, fakt ky i theksuar nga z. F. A. në deklaratën periodike për vitin 2004, e cila logjikisht duket se vjen si vazhdim i deklaramit të së njëjtës pasuri me atë të deklaruar në deklaratën për herë të parë, në mars të 2004, çmuar kjo jo vetëm në drejtim të raporteve të pronësisë së deklaruar, por edhe të vlerës së pasurisë, e cila në total është deklaruar në shumën 8 milionë lekë dhe gjysma e saj në vlerën 4.000.000 lekë. Ndërthurja në këtë deklaram dhe referimi te “vila dy katëshe” e ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, nga të dy deklaruesit, subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, vlerësuar në raport me datat e dorëzimit të këtyre deklaratave, 15 dhe 17 mars 2005, periudhë kjo e afërt me datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, më 20.05.2005, ku çmimi i shitblerjes referohej i shlyer, krijoi bindjen te trupi gjykues se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasaktësinë në deklaramin e vitit 2004, ishin të besueshme.

69. Në këto kushte, trupi gjykues, në konsideratë të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbi vlerën provuese të deklarimeve periodike në procesin e rivlerësimit kalimtar, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se babai i subjektit të rivlerësimit në deklarimet e tij të analizuara më sipër, ka qenë para detyrimit ligjor për deklaramin e saktë të pasurive dhe interesave privatë të krijuar nga bashkëshortja e tij në kuptim të parashikimit të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.03.2004, arriti në përfundimin se pasuria e paluajtshme e deklaruar në deklaratën për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij i referohet “vilës dy katëshe”, pjesë e fshatit turistik të ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Rrjedhimisht, vlera e deklaruar si e investuar, i përket kësaj pasurie dhe jo asaj në fshatin turistik “{\*\*\*}”, si përlllogaritur nga ana e Komisionit. Përfundimisht, trupi gjykues arriti në përfundimin se në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, vlera e pasurisë objekt kontrolli është 8 milionë<sup>28</sup> lekë, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, jo 40.000 USD, sipas kontratës noteriale të shitblerjes dhe as sa përlllogaritur nga Komisioni, në shumën 12.133.200 lekë<sup>29</sup>.

---

<sup>27</sup> Referuar kartelës së pasurisë së blerë nga shoqëria “{\*\*\*}”, por edhe përmbajtjes së kontratës noteriale të shitjes, kjo pasuri ka qenë e regjistruar që në momentin kur është regjistruar fshati turistik, më datë 14.05.2002.

<sup>28</sup> Vlerë kjo e njëjtë me sa deklaruar nga z. F. A. në deklaratën periodike të vitit 2005.

<sup>29</sup> Referuar zërit “Vilë dykatëshe në fshatin “{\*\*\*}””, në tabelën nr. 1, në faqen 38 të vendimit të Komisionit.

➤ *Lidhur me disponimin/posedimin/gëzimin e pasurisë së paluajtshme “vilë dykatëshe” me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimi 214 m<sup>2</sup>, e ndodhur në bllokun e vilave në Golem të ndërtuara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e cila është deklaruar si burim për krijimin e vilës dykatëshe të blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK:*

70. Lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, të ardhurat nga shitja e së cilës janë pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si burim për pagesat e kryera shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për blerjen e vilës dykatëshe, sipas kontratës noteriale të lidhur për këtë qëllim në vitin 2005, Komisioni, në përfundim të kontrollit të kryer, ka vlerësuar se: *lidhur me dyshimet e ngritura se pasuria e llojit vilë dykatëshe (pjesa takuese), e ndërtuar në Golem në funksion të lejes së ndërtimit të nxjerrë për shoqërinë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, me financues/investitor shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, është në disponim dhe/apo posedim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se ai nuk arriti që të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se këtë pasuri e posedon, disponon dhe gëzon vetëm shtetasi N.H., kjo për sa kohë nuk kemi deklarim konkret për heqjen dorë nga të drejtat mbi këtë pasuri, nga nëna e subjektit, znj. K.A. Gjithsesi, Komisioni vëren se kjo është një pasuri që nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, porse hetimi i kryer për të ka pasur lidhje me vërtetimin e provueshmërisë së deklaramëve të bëra mbi të ardhurat e përfituara prej familjarëve të tij si rezultat i heqjes dorë prej kësaj pasurie, të cilat janë referuar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.*

71. Lidhur me këtë çështje, në vijim të analizës së mësipërme dhe referuar akteve të administruara në fashikullin e Komisionit<sup>30</sup>, trupi gjykues krijoi bindjen mbi vërtetësinë e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, se pasuria e paluajtshme e llojit shtëpi dykatëshe, e ndërtuar në Golem me financues shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, është në pronësi të shtetasit N. H., pa qenë e nevojshme marrja e provave të reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, sipas të cilave rezultonte se në emër të z. N. H. ishte lëshuar Certifikata për Regjistrimin e Pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me nr. {\*\*\*} në Zonën Kadastrale nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe totale 419 m<sup>2</sup>, në zonën e stimuluar “{\*\*\*}” Golem, sipas kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.10.2005, të lidhur para noterit A. Z., mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. N. H. në cilësinë e porositësit.

➤ *Lidhur me vlerësimin e burimeve financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016:*

72. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në drejtim të shtrirjes së analizës financiare të kryer nga Komisioni në verifikimin e ligjshmërisë së të gjitha pasurive të prindërve të subjektit të

---

<sup>30</sup> *Librezë e ujit të shtetasit N. H. me nr. kontrate {\*\*\*}, si dhe disa mandate arkëtimi për vitet 2020 dhe 2022; librezë për furnizimin me energji elektrike në banesën e N. H. për kontratën {\*\*\*}, si dhe një mandat arkëtimi; vërtetim i lëshuar nga Njësia Administrative Golem nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2022; deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 08.05.2022, e shtetasit S. Sh.*

rivlerësimit ndër vite, trupi gjykues, në zbatim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, huamarrësit apo dhuruesit, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, e gjen të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se analiza e Komisionit duhet të kufizohet vetëm në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të përdorura për të justifikuar pasurinë objekt dhurimi, sipas nenit 32, paragrafi 4 i ligjit të sipërcituar.

73. Në përfundim të sa më sipër, pasi mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përlllogaritjen e zërit të shpenzimeve të jetesës dhe përfshirjen në analizën e kryer mbi mundësinë financiare të prindërve edhe të të ardhurave të tij, të cilat i gjeti të drejta e të bazuara, në konsideratë edhe të konkluzioneve të arritura nga trupi gjykues më sipër në këtë vendim, pas korigjimit të analizës financiare të kryer nga Komisioni mbi bazën e sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se, pavarësisht nevojës për të justifikuar me burime të ligjshme vetëm pasurinë objekt dhurimi (1/3 e vlerës së pasurisë së paluajtshme në fshatin turistik “{\*\*\*}”, në shumën 2.666.666 lekë), prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultuan me burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar të gjitha investimet e kryera ndër vite në pasuri të paluajtshme, si evidentuar në tabelën nr. 1, faqe 38, në vendimin e Komisionit<sup>31</sup>.
74. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se, lidhur me pasurinë e paluajtshme ndërtesë dykatëshe (një kat plus papafingo) e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Kavajë, te kompleksi turistik i ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ku subjekti i rivlerësimit është bashkëpronar me 1/3 pjesë takuese, trupi gjykues arriti në përfundimin se nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të saktësisë së deklarimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>31</sup> Në ndryshim nga analiza financiare e Komisionit, në Kolegj u përlllogarit:

1. vlera e investuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për apartamentin në Tiranë, u përlllogarit në shumën 4.000.000 lekë;

2. shpenzimet e jetesës për prindërit e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 -1999, u përlllogaritën në masën 30% të të ardhurave të përfutuara nga pagat respektive, në shumën totale prej 1.205.790 lekësh, në përputhje me standardin e vendosur në vendimin orientues të Kolegjit nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021, në kushtet kur, për shkak të detyrave të larta shtetërore të ushtruara nga babai i subjektit në këtë periudhë (deputet i Kuvendit të Shqipërisë, anëtar i Gjykatës Kushtetuese), pagat e përfutuara kanë qenë edhe më të larta se ato të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

3. në analizë u përfshinë të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995-2002, në shumën 2.359.655 lekë, dhe shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë, si dhe shpenzimet e kryera për blerjen e një automjeti, në shumën totale prej 796.493 lekësh;

4. vlera e pasurisë në fshatin turistik “{\*\*\*}” u përlllogarit në shumën totale prej 8.000.000 lekësh;

5. shuma prej 4.000.000 lekësh, e paguar në vitin 2004 nga N. H., u përfshi në vitin 2005 si e kthyer prindërve të subjektit së bashku me shumën prej 25.000 USD.

Kjo analizë e korigjuar rezultoi me balancë pozitive.

75. Lidhur me *shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.*
76. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e automjetit, krijimin e depozitës bankare, shtesën e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të konstatuara nga Komisioni, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera gjatë vitit 2009, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Konkluzionin e sipërcituar, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se: *trupi gjykues krijoi bindjen se në këtë rast, vlera e shënuar si çmim në kontratën e shitblerjes së datës 5.10.2009, nuk përfaqëson vlerën reale të paguar nga subjekti për blerjen e këtij automjeti. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se në kontratën e shitblerjes së këtij automjeti, është shënuar një çmim fiktiv, me qëllim për të fshehur vlerën reale të blerjes së tij. [...] Në kushtet kur subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, në analizën financiare të kryer për vitin e blerjes së këtij automjeti, vlera e pasurisë objekt vlerësimi do reflektohet në shumën 2.100.000 lekë, që përfaqëson vlerën e blerjes, plus detyrime doganore të paguara nga shitësi, z. J. N.*
77. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë automjet dhe analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, duke pretenduar se Komisioni ka gabuar në përcaktimin e vlerës së shpenzuar për blerjen e automjetit ndryshe nga sa përcaktuar në kontratën e shitblerjes së tij.
78. Subjekti pretendoi se argumentet e përdorura nga Komisioni lidhur me përcaktimin e çmimit të shitblerjes së automjetit në shumën e 2.100.000 lekëve, nuk janë të bazuara, por thjesht supozime. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, përcaktimi në kontratë se: *dorëzimi i mjetit është bërë duke mos pasur blerësi pretendim për gjendjen teknike të tij*, nuk kundërshton sa pretenduar nga subjekti për ekzistencë të problemeve teknike të mjetit, për më tepër tregon pikërisht kujdesin e shitësit që në kushtet kur ishin konstatuar defekte, të mos ngriheshin pretendime në të ardhmen për gjendjen teknike të tij. Subjekti pretendoi gjithashtu se i pabazuar është edhe arsyetimi i Komisionit se, nga kontrolli teknik që i është ushtruar mjetit pas blerjes, nuk kanë rezultuar problematika, për sa kohë, sipas tij, gjatë kontrollit fizik të mjetit nuk verifikohen kilometrazhi, sistemi i kondicionimit apo gjendja e sediljeve të mjetit, të cilat kanë çuar në reduktimin e çmimit të automjetit, përveç nevojës urgjente të shitësit për likuiditete. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, duke argumentuar se në legjislacionin shqiptar nuk ka asnjë dispozitë ndaluese lidhur me shitjen e sendeve nën çmimin e tregut apo më lirë se ç’ mund të jenë blerë, kërkoi që analiza financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për blerjen e tij, të kryhet

duke shënuar si vlerë të automjetit vlerën e përcaktuar në kontratën noteriale, e cila, sipas tij, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>32</sup>, përbën vlerë të plotë provuese.

79. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se me anë të kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.10.2009, mes palëve J. N. në cilësinë e shitësit dhe Altin Abdiu në cilësinë e blerësit është lidhur kontrata për shitblerjen e pasurisë së luajtshme e llojit automjet, e markës “Daimler Chrysler”, tipi 211, prodhim i vitit 2005, me nr. shasie: {\*\*\*}, të cilën shitësi ia ka shitur subjektit të rivlerësimit përkundrejt shumë 950.000 lekë. Si referuar edhe nga Komisioni në vendim, bazuar në aktet e dosjes së mjetit të përcjellë nga DPSHTRR, automjeti është importuar nga ana e z. J. N., i cili rezultoi ta ketë blerë automjetin në Gjermani, përkundrejt çmimit prej 11.900 eurosh (sipas referimit në një akt të përkthyer, me titull: *GEBR. OLBRING AUTOMOBILE GMBH Auto Export* dhe me përshkrim *Faturë – Çmimi i blerjes 11.900,00 euro*<sup>33</sup>), si dhe ta ketë zhdoganuar atë përkundrejt pagesës së detyrimit doganor prej 529.191 lekësh, situatë faktike kjo e pakundërshtuar nga ana e subjektit të rivlerësimit.
80. Nga verifikimi i akteve të fashikullit, trupi gjykues nuk konstatoi asnjë provë apo indicie në drejtim të sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit mbi problematika në gjendjen teknike të automjetit, të cilat pretendohet që të kenë shërbyer si faktor thelbësor në shitjen e automjetit me një diferencë të theksuar në ulje të çmimit të investuar nga shitësi. Në të njëjtin nivel deklarativ mbetën edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se ulja e çmimit të automjetit nga shitësi, një tregtar automjetesh dhe jo thjesht një person që po tjetërsonte automjetin në pronësi, i atribuohet nevojës së këtij të fundit për likuiditete, si pasojë e një emergjence mjekësore. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë se në procesin e rivlerësimit kalimtar, bazuar në parashikimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barrën e provës për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit nga hetimi administrativ, e ka subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e arritur prej këtij të fundit në vendim, për sa kohë dyshimi i arsyeshëm i ngritur fillimisht nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, se vlera e shënuar në kontratën e shitblerjes së automjetit objekt kontrolli e datës 05.10.2009, nuk përfaqëson vlerën reale të paguar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti, mbeti i tillë edhe pas shqyrtimit të ankimit.
81. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues gjen të drejtë dhe të bazuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e burimeve të ligjshme për shpenzimin e kryer për blerjen e këtij automjeti, në shumën e përlllogaritur prej 2.100.000 lekësh (vlera e blerjes dhe detyrimit doganor të paguara nga shitësi), për sa kohë edhe pas shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë trupin gjykues se vlera e investuar për blerjen e këtij automjeti është ajo e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, rreth dyfish më e ulët se kostoja e blerjes së tij prej shitësit,

---

<sup>32</sup> Subjekti ka referuar vendimin e Kolegjit nr. 11/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit E. I., si dhe vendimin nr. 5/2019 që i përket subjektit A. C..

<sup>33</sup> E konvertuar në 1.571.493 lekë sipas kursit zyrtar mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2009, 1 euro = 132,06 lekë.

rreth 1 muaj më parë. Bazuar në sa më sipër, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si ky i fundit, se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e (-) 1.117.048 lekëve për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

82. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit të konkluzionit të Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së llojit “likuiditete” në formën e depozitës bankare me afat njëvjeçar në Credins Bank, në shumën 20.000 euro, të investuar në datën 11.11.2016, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se:*
83. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e depozitës në shumën 20.000 euro, në datën 20.10.2014, në Raiffeisen Bank. Në kushtet kur fondet e depozituara në datën 24.10.2014, në Raiffeisen Bank, janë konstatuar si burimi fillestar i krijimit të depozitës në shumën 20.000 euro, në Credins Bank, deklaruar si pasuri në deklaratën *vetting*, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e depozitës në Credins Bank, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Konkluzionin e sipërcituar, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin: *Në formularët e deklaramit të pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, që i përket deklaratës së interesave privatë të vitit 2013, kërkohet nga deklaramit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) të ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Për më tepër, Komisioni vëren se ka një diferencë të konsiderueshme kohore midis tërheqjes së këtyre fondeve në dhjetor të vitit 2013 dhe, në vijim, depozitimit të së njëjtës shumë, në vlerën 20.000 euro, në tetor të vitit 2014. Në vijim të sa më sipër, në dritën edhe të jurisprudencës të Kolegjit<sup>34</sup>, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimit të likuiditeteve, është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe një pretendim jologjik.*
84. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar dhe të paarsyetuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe që, sipas tij, tregon haptazi paragjykimin e çështjes nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se burimi fillestar i depozitës në shumën 20.000 euro, në Credins Bank, deklaruar si pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*, janë fondet e depozituara fillimisht nga subjekti i rivlerësimit në datën 19.11.2012, në llogarinë në emër të tij në Credins Bank, në një depozitë me afat 1-vjeçar, për të cilën, në përfundim të afatit të maturimit, nuk ka deklaruar

---

<sup>34</sup> Komisioni ka referuar jurisprudencën e Kolegjit si vijon: vendimet nr. 7/2019 (JR) në pikat 32.4 dhe 32.5 të paragrafit nr. 32; nr. 11/2019 (JR), në pikën nr. 27.12.18 të paragrafit nr. 27; nr. 19/2019 (JR), në paragrafin nr. 84; nr. 20/2019 (JR), në paragrafin nr. 59; dhe nr. 29/2019 (JR), në paragrafin nr. 31.

tërheqjen e saj, duke vlerësuar që e kishte plotësuar këtë detyrim me deklarinimin fillestar mbi afatin e depozitës në krijimin e saj.

85. Konkluzioni i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, është tërësisht i pabazuar dhe në kundërshtim me disa vendime të Kolegjit të referuara nga subjekti jo vetëm në ankim<sup>35</sup>, por edhe në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, të cilat, sipas tij, Komisioni nuk i ka marrë në analizë. Subjekti pretendoi se Komisioni do të duhet të kishte marrë në konsideratë se: (i) subjekti i rivlerësimit, mosdeklarimin në deklaratën periodike të vitit 2013, të gjendjes *cash* në banesë prej 20.000 eurosh, si pakësim i depozitës në Credins Bank, në datën 10.12.2013, e ka korrigjuar në deklaratën periodike pasardhëse të vitit 2014; (ii) faktin se shumën prej 20.000 eurosh e ka deklaruar dhe në procesverbalin e mbajtur më 15 tetor 2014 para ILDKPKI-së, se e dispononte *cash* në shtëpi dhe se do e depozitonte në bankë, fakt i cili provohet nga lëvizja e llogarisë bankare të subjektit pranë Raiffeisen Bank; (iii) faktin që diferenca pozitive e analizës financiare të vitit 2013, vjen si rrjedhojë e ekzistencës së burimeve të ligjshme të të ardhurave të cilat janë deklaruar rregullisht, në momentin e krijimit të tyre; si dhe (iv) kohën relativisht të shkurtër nga momenti i tërheqjeve të likuiditetit nga llogaria bankare, më 10 dhjetor të vitit 2013 deri në datën 31.12.2013, datë në të cilën është përlllogaritur vlera e kursimit të mundshëm, për të ngritur një dyshim të arsyeshëm nga Komisioni në drejtim të shpenzimit të kësaj shume në tërësinë e saj.
86. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, pasi verifikoi deklarinimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me likuiditetet e tij në sistemin bankar në shumën 20.000 euro, të investuara në formën e depozitës me afat, përkatësisht në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të viteve 2012, 2014, 2015 dhe 2016, trupi gjykues vëren se vlerësimi lidhur me ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, “depozitë bankare me afat njëvjeçar, në shumën 20.000 euro”, e investuar në datën 11.11.2016, në Credins Bank, lidhet ngushtësisht me analizën e krijimit të depozitës në të njëjtën shumë në Bankën Raiffeisen, në vitin 2014, e cila ka vijueshmëri deri në momentin e deklarinimit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Çështja që shtrohet për diskutim nga trupi gjykues, është nëse si burim për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer kursimet e mëparshme, gjendje *cash* në banesë të akumuluar deri në nëntor të vitit 2012, sikundër ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ka pretenduar gjatë gjithë procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit, apo të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e depozitës së çelur në vitin 2014, janë vetëm ato të përlllogaritura si mundësi kursimi për periudhën 01.01.2014 - 24.10.2014, siç ka mbajtur qëndrim Komisioni në vendimin objekt ankimi.
87. Në kuadër të kësaj analize, nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se në datën 19.11.2012, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në Credins Bank, në llogarinë në emër të tij, vlerën prej 20.000 eurosh, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 1-vjeçar. Në vijim, pasi ka kaluar afati i maturimit të kësaj depozite, subjekti i rivlerësimit, në

---

<sup>35</sup> Shih paragrafin 238, faqet 49-53 të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

datën 10.12.2013, e ka mbyllur këtë llogari pasi ka tërhequr *cash* shumën e depozituar prej 20.000 eurosh së bashku me interesat.

88. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, në të cilën, në zbatim të parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, duhet të pasqyronte shtesat dhe pakësimet e pasurive të tij gjatë këtij viti, nuk rezultoi të ketë deklaruar as pakësimin e llogarisë së depozitës së çelur në vitin 2012 dhe as shtimin e gjendjes së likuiditetit *cash* në banesë. Gjithashtu, referuar parashikimit të ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive [...]”, i ndryshuar”, sipas të cilit u miratua edhe detyrimi për deklarinimin e shpenzimeve të kryera gjatë vitit të deklarinimit dhe që tejkalojnë vlerën prej 500.000 lekësh<sup>36</sup>, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, edhe pse ka pakësuar llogarinë bankare në shumën 20.000 euro në datën 10.12.2013, nuk rezulton të ketë deklaruar ndonjë shpenzim të kryer lidhur me këtë vlerë.
89. Nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2014, nuk konstatohet që nga subjekti i rivlerësimit të jetë deklaruar ndonjë pasuri e krijuar në këtë vit apo ndonjë shpenzim i kryer në kufijtë e shpenzimeve të deklarueshme sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.
90. Trupi gjykues konstaton se lidhur me qartësimin e situatës në raport me mbylljen e depozitës bankare në Raiffeisen Bank dhe destinacionin e shumës monetare të tërhequr më datë 10.12.2013, prej 20.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga ana e ILDKPKI-së më datë 15 tetor të vitit 2014, ku në procesverbalin e përpiluar, rezulton sa vijon: *Pyetja nr. 3: z. Abdiu, në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2012, keni deklaruar depozitë në Credins Bank, në shumën 20.000 euro. Credins Bank konfirmon depozitën 12-mujore me gjendje më 31.12.2012, në shumën 20.000 euro. Në datën 31.12.2013, kjo depozitë është 0 euro. Shuma është tërhequr në datën 10.12.2013. Përse nuk është deklaruar pakësimi/mbyllja e depozitës? Shpjegoni destinacionin e shumës prej 20.000 eurosh. Përgjigje: Në kuptimin juridik, unë kam deklaruar një depozitë me afat njëvjeçar që nënkupton se ajo do të mbyllet mbas një viti nga hapja e saj. Për këtë arsye, nuk e kam çmuar të nevojshme se duhej deklaruar mbyllja. Shuma prej 20.000 eurosh disponohet cash prej meje. [...] Pyetja nr. 13: Z. Abdiu, likuiditetet cash në banesë, në shumën mbi 1.500.000 lekë, duhet të depozitohen në bankë. Përgjigje: Do t'i depozitoj në bankë dhe pasqyrimin përkatës do e bëj në deklaratën pasardhëse.*
91. I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ lidhur me deklarinimin e gjendjeve *cash* të disponuara ndër vite jashtë sistemit bankar, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 1 të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: *[...] Në DPV-në e vitit 2013, kam deklaruar shtesë nga kursimet vjetore nga paga 100.000 lekë. Gjendja e cash-it në fund të vitit 2013, ka qenë 100.000 lekë dhe shuma 20.000 euro e tërhequr nga Credins Bank në datën 10.12.2013. Ky ka qenë veprim i pakësimit të bankës si rezultat i maturimit të depozitës dhe shtimit të cash-it mbas tërheqjes nga*

---

<sup>36</sup> Shih nenin 4, shkronja “h” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, që parashikonte detyrimin për deklarinimin nga subjektet deklaruese të çdo shpenzimi të deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 lekë, i kryer gjatë vitit të deklarinimit.

banka. Në DPV-në e vitit 2014, unë kam deklaruar se shuma prej 20.000 eurosh, me përshkrim “Kursime nga paga në vite”, është depozituar në datën 24.10.2014, po për një afat njëvjeçar. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim përgjatë gjithë procesit të rivlerësimit, si dhe në ankimin e tij.

92. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren fillimisht se nga një vlerësim i ngushtë i situatës faktike dhe i kufizuar vetëm në faktin e mosdeklarimit nga ana e subjektit të disponimit të shumës monetare prej 20.000 eurosh të tërhequr nga llogaria bankare, në datën 10.12.2013, si gjendje *cash* në banesë në datën 31.12.2013, në konsideratë të parashikimit ligjor të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit deklaratat periodike mund të merren si provë në këtë proces, të fakteve të deklaruara apo jo në to, qëndrimi i Komisionit për vlerësimin e depozitës së çelur në tetor të vitit 2014, në shumën prej 20.000 eurosh si të krijuar nga të ardhurat e atij viti, do të çmohej i bazuar në fakte dhe në ligj dhe në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.
93. Megjithatë, në kuadër të arritjes së një vendimmarrjeje të drejtë dhe të bazuar në një vlerësim më të hollësishëm e objektiv të situatës faktike dhe çmuarjes sipas bindjes së brendshme të shpjegimeve e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe provave mbi ekzistencën e kësaj shume monetare si gjendje *cash* në banesë, në intervalin kohor nga tërheqja e depozitës në dhjetor të vitit 2013 deri në depozitim të saj në tetor të vitit 2014, në kushtet kur ky mosdeklarim nga ana e subjektit të rivlerësimit, vendoset në një kontekst faktesh dhe rrethanash të cilat dëshmojnë për:
- (i) tërheqje të shumës si pasojë e maturimit të afatit të depozitës dhe jo si mbyllje/tërheqje e parakohshme, çka mund të përbënte indicie në drejtim të nevojës për përdorim fondesh monetare;
  - (ii) periudhë shumë të shkurtër kohore (vetëm 20 ditë) nga data e mbylljes së llogarisë dhe tërheqjes së shumës monetare, deri në datën 31.12.2013, datë në të cilën duhet të pasqyrohej në DIPPV-në e vitit 2013 gjendja e kursimeve *cash* në banesë, për të justifikuar dyshimin e arsyeshëm se mosdeklarimi ka ardhur si pasojë e shpenzimit të kësaj shume, arsyetim ky i bazuar në mungesën e të dhënave gjatë hetimit për shpenzime gjatë kësaj periudhe apo krijim pasurie;
  - (iii) rezultat pozitiv i analizës financiare të Komisionit për vitin 2013, me tepricë pozitive në shumën 3.132.138 lekë, më e madhe se vetë shuma e pakësimit të depozitës (prej 2.694.494 lekësh) dhe diferencë negative e konstatuar në analizën financiare të vitit 2014 me mungesë burimesh të ligjshme në shumën e 2.492.458 lekëve, më e vogël se shuma e depozituar prej 2.802.200<sup>37</sup> lekësh;
  - (iv) qëndrimin e mbajtur në ILDKPK që në vitin 2014, për pasaktësi në deklaram në DIPPV-në e vitit 2013 dhe deklaram i posedimit të kësaj shume gjendje *cash*, si dhe depozitimi në bankë në vijim i së njëjtës shumë prej 20.000 eurosh, shoqëruar me deklaramin në DIPPV-në e vitit 2014 me burim krijimi *Kursime nga paga në vite*, si dhe vazhdimi i mbajtjes së kësaj shume në bankë, në depozita të njëpasnjëshme për vite me radhë;
- trupi gjykues e gjeti të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi ekzistencën e kësaj shume monetare si gjendje *cash* në banesë, në intervalin kohor nga tërheqja e depozitës, në dhjetor të vitit 2013, deri në depozitim të saj, në tetor të vitit 2014. Për rrjedhojë, edhe konkluzioni i

---

<sup>37</sup> Shuma prej 20.000 eurosh, e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014.

Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, të llojit “depozitë” në Credins Bank, në shumën 20.000 euro, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, u gjet i pabazuar në fakte.

94. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për pasurinë e llojit “likuiditete”, gjendje cash, në shumën 5.000 euro, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
95. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e kësaj pasurie, ka arsyetuar se *pasuria e llojit “likuiditete” në gjendje cash, në shumën 5.000 euro, deklaruar në deklaratën “vetting”, ka si burim të ardhurat e përfutuara nga paga e subjektit për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016. Referuar analizës paraprake financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se viti 2014 paraqitet me balancë negative fondesh, vit në të cilin konstatohet se subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh cash në shumën 500.000 lekë, të cilat janë referuar dhe si burim krijimi i gjendjes cash në momentin e dorëzimit të deklaratës “vetting”. Pas analizimit të prapësimeve të depozituara nga subjekti, rezulton se pretendimet e tij mbi analizën financiare të vitit 2014, lidhen me ligjshmërinë e burimeve financiare të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitës 20.000 euro në Raiffeisen Bank. Në kushtet kur Komisioni, në vlerësimin përfundimtar, çmoi të mos marrë në konsideratë prapësimet e bëra nga subjekti lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite në vitin 2014, si i vetmi element i cili u kërkua të ndryshohej nga subjekti në analizën financiare të vitit 2014, analiza e treguesve financiarë e kryer nga Komisioni për këtë vit kalendarik, nuk ndryshon<sup>38</sup>.*
96. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar këtë konkluzion të Komisionit dhe pretendoi se nga përllogaritjet e kryera, vlera e kursyer e deklaruar për çdo vit prej tij, përputhet plotësisht me likuiditetin e depozituar në bankë dhe gjendjen *cash* në shtëpi të deklaruar në deklaratën *vetting*. Subjekti pretendoi se ky fakt duhet të kishte shërbyer si një argument që duhet të kishte bindur Komisionin për ligjshmërinë e likuiditetit të depozituar në llogari bankare në vitin 2014 e të shtuar deri në 25.000 euro në deklaratën *vetting*, si rrjedhojë edhe të gjendjes *cash* të deklaruar.
97. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton fillimisht se Komisioni, në konkluzionin e tij lidhur me këtë pasuri të llojit likuiditet në gjendje *cash* në banesë, nuk ka përcaktuar shprehimisht shumën e pajustificuar me burime të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 5.000 eurosh të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, sikundër rezultoi se dhe në konkluzionet përfundimtare mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, nuk ka mbajtur qëndrim lidhur me këtë pasuri<sup>39</sup>. Arsyetimi i Komisionit në vlerësimin e kësaj pasurie me mungesë burimesh të ligjshme, bazohet në faktin se në kushtet kur viti financiar 2014, në fund të të cilit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një shtesë likuiditeti *cash* nga të ardhurat e vitit në shumën e

---

<sup>38</sup> Duke referuar në rezultatin financiar të vitit 2014 të analizës përmbledhëse bashkëlidhur vendimit objekt ankimi, që rezulton me balancë negative në shumën e 2.492.458 lekëve.

<sup>39</sup> Shih konkluzionet e Komisionit në paragrafin 54, faqe 53-54 të vendimit të këtij të fundit.

500.000 lekëve, ka rezultuar me balancë negative, ky kursim nuk mund të ketë shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* prej 5.000 eurosh, duke mbetur si burime të ligjshme për krijimin e këtij likuiditeti vetëm kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2015 dhe 2016, vite të cilat kanë rezultuar me balanca pozitive në analizën financiare të Komisionit. Në këto kushte, në konsideratë të konkluzionit të arritur më sipër në këtë vendim se, për krijimin e depozitës në shumën 20.000 euro në tetor të vitit 2014 në Raiffeisen Bank, subjekti rezultoi me burime të ligjshme për krijimin e saj dhe, rrjedhimisht, me balancë pozitive të analizës së këtij viti, trupi gjykues arrin në përfundimin se kursimi i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në këtë vit, justifikohet me burime të ligjshme, duke u përlllogaritur si burim i ligjshëm për krijimin e gjendjes së likuiditetit *cash* në banesë në shumën 5.000 euro të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*.

98. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar në ligj të mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga shitja në vitin 2003 të pasurisë së llojit automjet i tipit “Mercedes Benz”, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
99. Komisioni, pasi i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime dhe prova lidhur me: (i) shitjen e këtij automjeti me çmim më të lartë nga ai i blerjes; si dhe (ii) depozitimin e dokumentacionit justifikues ligjor për pagesën e tatimit mbi të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja, ka vlerësuar në përfundim të procesit të rivlerësimit se e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se ai, referuar legjislacionit të kohës, nuk kishte detyrim ligjor për të paguar tatim lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit, duke qenë se germa “g”, sipas së cilës: *të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose [...], është shtuar në paragrafin e parë të nenit 8 të ligjit nr. 9438, datë 28.12.1998, në vitin 2004, pas shitjes së automjetit. Por, nga ana tjetër, Komisioni ka vlerësuar të mos e ndryshojë analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit për periudhën në fjalë, duke qenë se subjekti nuk kishte dhënë shpjegime mbi shitjen e kësaj pasurie me një çmim 2,5 herë më të lartë se çmimi i blerjes. Komisioni është shprehur gjithashtu në vendim se sa më sipër nuk ndikon në rezultatin e analizës për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003.*
100. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vlerësuar gabimisht që të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja e pasurisë së luajtshme, automjetit të markës “Mercedes Benz” në datën 19.06.2003, paraprakisht të mos përfshihen në analizën financiare për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, sepse, sipas Komisionit, deri në këtë fazë të hetimit nuk vërtetohej shlyerja e detyrimeve përkatëse tatimore për fitimin e realizuar. Subjekti pretendoi se përderisa Komisioni formalisht e ka pranuar argumentin e paraqitur nga subjekti se nuk ka pasur detyrim ligjor për pagesën e tatimit për vlerën që ka referuar Komisioni, rrjedhimisht duhet ta kishte përfshirë këtë vlerë monetare në analizën e tij financiare. Subjekti pretendoi se automjeti është shitur në një vlerë më të lartë për shkak të investimeve të bëra gjatë kohës që e ka pasur në pronësi dhe, për sa kohë nuk ka pasur detyrim ligjor për pagesë tatimi, duhet të merret në konsideratë vlera e plotë e shitjes së tij.

101. Në lidhje me shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, trupi gjykues fillimisht konstatoi se, referuar rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni, sikundër me të drejtë ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, nuk i ka përfshirë të ardhurat e deklaruara nga shitja e automjetit, pasi sipas tij: *deri në këtë fazë të hetimit nuk vërtetohet shlyerja e detyrimeve përkatëse tatimore për fitimin e realizuar [çmim shitje – (çmim blerje + shpenzime të tjera)]*. Rrjedhimisht, pasi u provua se, referuar legjislacionit të kohës, subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrim për të paguar tatim lidhur me të ardhurat e realizuara nga shitja, trupi gjykues vlerëson se Komisioni duhet të kishte mbajtur një qëndrim të ndryshëm në lidhje me vlerësimin e këtyre të ardhurave, pavarësisht faktit që përfshirja e tyre nuk sillte ndikim në analizën financiare të vitit 2003, për sa kohë nga hetimi nuk kishte rezultuar asnjë e dhënë që: (i) çmimi i shitjes së automjetit, 300.000 lekë më i lartë se ai i blerjes së tij, të kishte shërbyer si një formë e fshehjes së një situatë financiare me rezultat negativ, përkundrazi rezultati i këtij viti, referuar analizës së Komisionit, pa përllogaritjen e këtyre të ardhurave, konstatohet të jetë me balancë pozitive (+) 1.280.431; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja të ishin deklaruar si një burim për krijimin e një tjetër pasurie, e pamundur për t'u krijuar me të ardhura të tjera të ligjshme; apo (iii) ndonjë e dhënë që lidhej me konstatimin e një situatë trajtimi preferencial nga shitësi për shkaqe që lidheshin me detyrën e subjektit.
102. *Lidhur me pasurinë e llojit automjet i tipit “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2008 dhe shitur në vitin 2009*, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën e 249.171 lekëve, rezultat të cilin subjekti i rivlerësimit duket ta ketë pranuar. Edhe në ankim, subjekti shprehet se ky rezultat, sipas tij, është e vetmja diferencë negative, e cila, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk mund të shërbejë e vetme për marrjen e masës disiplinore.
103. Në lidhje me analizën financiare të kryer për verifikimin e kësaj pasurie, trupi gjykues vëren se nuk ngrihen pretendime nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, ky rezultat financiar për këtë vit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me zbatimin e parimit të proporcionalitetit u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues në kuadër të rezultatit të analizës financiare për periudhën e rivlerësimit 2003-2016.
104. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën prej 1.411.422 lekësh. Në vlerësim të situatës faktike sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, trupi gjykues çmoi se problematikat e trajtuara si më sipër, në tërësinë e tyre, nuk e cenojnë besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
105. Në përfundim të këtij gjykimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Altin Abdiu ka arritur: (i) nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) nivel të besueshëm në

kontrollin e figurës; dhe (iii) nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale; si dhe (iv) nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, trupi gjyqës çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu, duhet të ndryshohet dhe subjekti i rivlerësimit të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjyqës, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 543, datë 28.06.2022, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.05.2025, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi – kundër*

#### **RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes nr. 38/2022 (JR), jam kundër vendimit nr. 43, datë 27.05.2025, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi: *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 543, datë 28.06.2022, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu*. Në vijim do të parashtroj argumentet mbi të cilat mbështes qëndrimin tim kundër këtij vendimi.
2. Në analizë të të gjitha akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna nga subjekti në Komision, si dhe pretendimeve të ngritura në Kolegj, bazuar në ligjin e zbatueshëm në këtë proces, në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit Altin Abdiu nuk rezulton i besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, nuk mund të konfirmohet në detyrë. Mosarritja e këtij niveli besueshmërie, ka ardhur si pasojë e vlerësimit në tërësi të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, i cili ka mbajtur në mënyrë të vazhdueshme qëndrime kontradiktore lidhur me të gjitha pasuritë e tij, çka cenon besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e deklarimeve të paraqitura prej tij, të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të konsiderueshme për krijimin e pasurive, të mjaftueshme këto për të bërë të zbatueshëm nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

*I. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, në Njësinë Bashkiake nr. 7, Tiranë:*

3. Komisioni, në vendim, për këtë pasuri ka konkluduar se: *në analizë përfundimtare të marrëdhënies së deklaruar dhe asaj të dokumentuar me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe familjarëve Abdiu, si edhe duke pasur në konsideratë deklaratimet kontradiktore të bëra në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të dy pasurive, apartamenteve të ndodhura në objektin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë (njëri prej të cilëve është pasuria objekt vlerësimi), arrin në përfundimin se veprimet dhe deklaratimet e subjektit kanë pasur si qëllim bërjen të pamundur të verifikimit të mënyrës së përfitimit dhe burimit real të krijimit të këtyre pasurive.*
4. Shumica e trupit gjykues për këtë pasuri, ka konkluduar: *në përfundim të analizës së shkakut të ankimit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, në Njësinë Bashkiake nr. 7, Tiranë, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të saktësisë së deklaratimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e saj, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.*
5. Në cilësinë e gjyqtares në pakicë, vlerësoj se për zgjidhjen e drejtë të çështjes në fjalë, nuk ka qenë e mjaftueshme vetëm dhënia përgjigje shkaqeve të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, siç ka vepruar shumica në vendim, por duhej thelluar edhe me analizimin e situatës faktike ligjore

në tërësi, për sa cituar në vendimin e Komisionit, se veprimet dhe deklaratimet e subjektit kanë pasur si qëllim bërjen të pamundur të verifikimit të mënyrës së përfitimit dhe burimit real të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi.

6. Për këtë pasuri, referuar deklaratës së pasurisë *vetting*, ka rezultuar se:

6.1. Në datën 07.09.1993, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë blerë nga Ndërmarrja Komonale Banesa Tiranë, pasurinë e llojit *apartament banimi* (nr .4) me sipërfaqe 76,7 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 13.520 lekë. Në datën 27.05.1999, subjekti i rivlerësimit së bashku me prindërit dhe motrën e tij kanë blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Tiranë, pasurinë e llojit *apartament banimi* (nr. {\*\*\*}), me sipërfaqe 37,6 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, në rrugën “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, shkalla {\*\*\*}, për vlerën 458.386 lekë.

6.2. Në datën 01.07.1999, pas bashkimit të dy pasurive, apartamenteve të përshkruara si më sipër, është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie, referuar të cilit është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe motrës së tij, pasuria e llojit *apartament banimi* me sipërfaqe 114,3 m<sup>2</sup>. Rezulton se subjekti zotëron 3/10 pjesë takuese të kësaj pasurie.

6.3. Në datën 19.11.2002, mes subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu, prindërve, motrës së tij dhe shtetasit Rr. H., me cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nënshkruhet deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.11.2002, sipas së cilës palët kanë shprehur dakordësinë për të shkëmbyer apartamentet në pronësi të familjes Abdiu (dy hyrje më vete), të ndodhura në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me dy apartamente me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, të ndodhura në bulevardin “{\*\*\*}”, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK (pronë e saj). Gjithashtu, në këtë deklaratë përcaktohet se kontrata e shkëmbimit të këtyre pronave do të bëhet menjëherë pas regjistrimit të Kullës nr. {\*\*\*} në ZVRPP Tiranë dhe se kjo deklaratë do të ketë fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit.

6.4. Në datën 19.11.2002, mes subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe motrës së tij, është nënshkruar deklarata për pjesëtim vullnetar (shkresë e thjeshtë), në të cilin përcaktohet se: [...] në datë 19.11.2002, bëjnë pjesëtimin vullnetar të dy apartamenteve që kanë në bashkëpronësi, me sipërfaqe të përgjithshme 200 metra katrorë, kati {\*\*\*}, Kulla {\*\*\*}, të cilët ndodhen në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, për shkak se këto dy apartamente nuk janë të regjistruara në hipotekë, si më poshtë: a) Altin Abdiu merr në pronësi apartamentin numër një të shënuar në planimetrinë që i bashkëngjitet këtij akti me sipërfaqe 90 metra katrorë [...]; b) ndërsa apartamenti tjetër me numër dy [...] me sipërfaqe të përgjithshme 110 metra katrorë, kalon në bashkëpronësi të F. A., K. A. dhe R. A. me nga 1/3 pjesë.

6.5. Pra, për këtë pasuri, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar zotërimin e apartamentit të banimit me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, në Njësinë Bashkiake nr. 7, rruga “{\*\*\*}”, ndërtesa nr. {\*\*\*}, hyrja {\*\*\*}, nr. {\*\*\*}, në vlerën 465.953 lekë, që, referuar

deklarimit, i përgjigjet ½ së çmimit total për blerjen e apartamentit me të cilin është shkëmbyer kjo pasuri dhe vlerës prej 280.000 lekësh si investim të kryer prej tij mbi këtë pasuri në vitin 2013.

7. Referuar sa më sipër, për mua, gjyqtaren në pakicë, rëndësi, fillimisht, ka verifikimi i faktit juridik nëse shkëmbimi i këtyre pasurive ka ndodhur realisht. Shumica nuk i ka dhënë zgjidhjen e duhur ligjore kësaj situatë juridike, të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Referuar nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.
8. Sipas deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në deklaratat periodike vjetore, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, krahasuar me deklaratat periodike të personit tjetër të lidhur, babait të subjektit, çmoj se shkëmbimi i pasurive nuk ka ndodhur asnjëherë, dhe subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të paqarta, kontradiktore, duke krijuar konfuzion mbi situatën faktike dhe, për pasojë, duke vështirësuar kontrollin e vlerësimit të pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Më konkretisht:

(i) Rezulton se pronësia mbi një send të paluajtshëm mund të fitohet me anë të kontratës së shkëmbimit, nëpërmjet së cilës bëhet kalimi i ndërsjellë i pronësisë mbi sendet e shkëmbyera dhe se palët duhet t'i dorëzojnë njëra-tjetrës sendet e caktuara për këmbim. Sipas deklarimeve në deklaratën noteriale, kontrata e shkëmbimit midis këtyre pronave do të bëhet menjëherë pas regjistrimit të Kullës nr. {\*\*\*} në ZRPP-në Tiranë dhe se kjo deklaratë do të ketë fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit. Kontratë e cila nuk është lidhur akoma e, për pasojë, mungon dokumenti mbi bazën e të cilit subjekti i rivlerësimit dhe/apo familjarët e tij kanë fituar pronësinë mbi apartamentet e ndërtuara nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK.

(ii) Pasuria në rrugën "{\*\*\*}", objekt shkëmbimi me apartamentin me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> të ndërtuar nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK, në momentin e nënshkrimit të deklaratës së shkëmbimit të pasurive, ka qenë vendosur si garanci hipotekare (kolateral) për sigurimin e kredisë së marrë nga babai i subjektit për blerjen e apartamentit të porositur në objektin e ndërtuar nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK. Referuar kontratës së hipotekimit të datës 11.04.2001, subjekti i rivlerësimit ka shprehur dakordësinë e tij që apartamenti i ndodhur në rrugën "{\*\*\*}", Tiranë, në të cilin ai zotëron 3/10 pjesë takuese, të vendoset si kolateral për sigurimin e kredisë së marrë nga babai i tij në Bankën e Kursimeve (sot "Raiffeisen Bank"). Subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të plotë se pasuria në pronësi të familjes së tij nuk mund të shkëmbehet me apartamentet e shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK, për sa kohë ajo ka qenë me barrë hipotekare për sigurim kredie, për blerje apartamenti të porositur nga babai i tij te kjo shoqëri.

(iii) Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk u administrua asnjë provë/dokument mbi bazën e të cilit të provohet dorëzimi i këtyre sendeve pas dhënies së pëlqimit për shkëmbimin e tyre si p.sh., procesverbal dorëzimi etj., ndërmjet familjarëve të familjes Abdiu dhe shoqërisë "{\*\*\*}"

ShPK. Po ashtu, rezulton se në deklaratën e shkëmbimit, nuk është pasqyruar dokumentacioni mbi bazën e të cilit palët dispononin të drejta pronësie/reale mbi pasuritë e dakordësuara për shkëmbim, si edhe nuk janë përcaktuar saktësisht dhe me të dhëna të plota pasuritë, apartamentet objekt shkëmbimi, si elemente kryesore të një kontrate shkëmbimi.

(iv) Pasuria në rrugën “{\*\*\*}” vijon të jetë ende e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve. Pretendimi i subjektit është i pabazuar kur referon si pengesë për nënshkrimin e kontratës së shkëmbimit, mungesën e regjistrimit të pasurive nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Të paktën deri në janar të vitit 2012, në rrethana hipotetike, vetë pasuria e familjarëve Abdiu nuk mund të ishte objekt kontrate shkëmbimi, në kushtet kur mbi të ishte vendosur barrë hipotekare për sigurim kredie (mund të kryhej shkëmbimi nëse paguhej kredia dhe lirohej pasuria, si edhe nëse banka jepte pëlqimin e saj për shkëmbimin e pasurive), praktikë ligjore që nga aktet në dosje, nuk rezulton të jetë kryer.

(v) Subjekti, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 24.06.2022, ka pranuar se ka pasaktësi në deklarinë e tij lidhur me këtë pasuri, kjo kryesisht e lidhur me dijeninë e tij mbi përdorimin e shumës prej 2.500.000 lekësh të marrë nga babai në vitin 2001. Si përfundim, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për pasuritë e përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, kanë shërbyer shkëmbimi i dy apartamenteve në rrugën “{\*\*\*}”; kredia në shumën 2.500.000 lekë e përfutur nga babai.

(vi) Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.11.2000, rezulton se babai i subjektit ka porositur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme prej 111 m<sup>2</sup>, i ndodhur në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë, kundrejt çmimit 44.400 USD (konvertuar në shumën rreth 6.600.000 lekë). Në kontratën e sipërmarrjes, ashtu si konstatuar më sipër, është përcaktuar plani i pagesave të vlerës së apartamentit si vijon: (i) 2.500.000 lekë nëpërmjet kredisë së dhënë nga Banka e Kursimeve; (ii) diferenca është likuiduar nga porositësi me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kësaj kontrate. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në momentin e lidhjes së kontratës, nuk është kryer nga babai i tij pagesa e shumës 4.100.000 lekë (diferenca mes çmimit të pasurisë dhe vlerës së pasqyruar si të paguar me transfertë bankare), pasi përcaktimi në kontratë është bërë me qëllim përfitimin e kredisë nga babai i tij dhe se për më tepër apartamenti i porositur prej tij, i është shitur një shtetasi tjetër dy muaj më pas. Në vlerësimin tim, shpjegimet e dhëna nga subjekti mbeten në nivel deklarativ dhe pretendimet se në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në datën 20.11.2000, nuk është paguar nga babai i tij shuma prej rreth 4.100.000 lekësh, në funksion të shlyerjes së çmimit të pasurisë objekt kontrate, dhe apartamenti në fjalë u është shitur të tretëve, mbetën të paprovuara.

(vii) Nga analizimi në harmoni i deklarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit me dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, çmoj se shuma prej 4.100.000 lekësh (pasqyruar si pagesë e kështit të parë në funksion të kontratës së porosisë të lidhur nga babai i subjektit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2000) ka shërbyer si burim për krijimin e pasurive

të përfituara prej familjarëve Abdiu nga kjo shoqëri, të cilat në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, kanë qenë në posedim të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij.

(viii) Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kemi të bëjmë me një lloj të veçantë kompensimi me shkëmbim, pasi në këtë rast sendet e pretenduara si të shkëmbyera nuk kanë të njëjtën vlerë, konstatohet se pala që ka marrë sendin me vlerë më të madhe (familja Abdiu), i ka paguar palës tjetër (shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK) një shumë parash në kompensim. Ky lloj veprimi, në rastet kur kompensimi është aq i madh sa vlera e objektit kryesor të kontratës apo edhe më i madh se kaq, çmoj se paraqet një situatë ku në të vërtetë nuk ka pasur asnjëherë shkëmbim, por vetëm kontratë porosie për blerje apartamenti.

9. Sa më sipër, çmoj se nuk ka pasur marrëdhënie shkëmbimi mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe familjarëve Abdiu, pasi, përveçse sa u arsyetua më sipër, rezulton e provuar se: (i) *babai i subjektit kishte lidhur më parë një kontratë porosie me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe kishte kryer pagesa në funksion të kësaj kontrate; (ii) pasuria objekt shkëmbimi (pasuria e familjes Abdiu) ishte vendosur si kolateral për sigurim kredie; (iii) apartamenti objekt shkëmbimi në rrugën “{\*\*\*}”, figuron edhe sot de jure në pronësi të familjes Abdiu; (iv) në deklaratën e shkëmbimit nuk është pasqyruar dokumentacioni mbi bazën e të cilit palët dispononin të drejta pronësie/reale mbi pasuritë e dakordësuara për shkëmbim, si edhe nuk janë përcaktuar saktësisht dhe me të dhëna të plota pasuritë, apartamentet objekt shkëmbimi; si edhe (v) në deklaratën e shkëmbimit nuk është referuar fakti i dhënies së një vlere monetare në funksion të kësaj marrëdhënieje (të paktën sipas vetëdeklarimit të subjektit, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, babai i tij i kishte dhënë më parë shumën 2.500.000 lekë, krahas apartamentit në “{\*\*\*}”, në funksion të përfitimit të dy pasurive në objektin e ndërtuar prej saj).*
10. Unë, gjyqtarja në pakicë, në konkluzion të analizës më sipër, vlerësoj se në asnjë rrethanë nuk është provuar ligjërisht shkëmbimi i pasurive, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që ai figuron ende pronar *de jure* i pasurisë në rrugën “{\*\*\*}” dhe posedues së bashku me familjen e tij i pasurive të ndërtuara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, që prej vitit 2002. Pretendimet e tij lidhur me shkëmbimin e pasurive, nuk e kaluan nivelin deklarativ. Në kuadër të kërkesave të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të shpjegonte bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive e të të ardhurave të tij dhe të personave të tjerë të lidhur me të. Neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon në mënyrë eksplicite se: *nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën*. Shumica e trupit gjykues, në mungesë objektiviteti, i ka marrë të mirëqena të gjitha shpjegimet e subjektit, pa analizuar në mënyrë të drejtë aktet e administruara në dosjen gjyqësore.
11. Në vlerësimin tërësor për këtë pasuri, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se qëllimi i vetëm i subjektit të rivlerësimit ka qenë që, nëpërmjet pretendimit se pasuritë objekt analize janë shkëmbyer, të justifikojë burimin e krijimit për pasuritë e përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK,

në mënyrë jo të drejtë, sa i përket kohës së ndërtimit, sipërfaqes së apartamenteve dhe vlerës së vogël të pretenduar si kompensim për të realizuar shkëmbimin vetëm prej 2.500.000 lekësh. Në bindjen time, për pasurinë e shkëmbyer apartament banimi objekt shqyrtimi, përveç kredisë është paguar edhe shuma 4.100.000 lekë, si përcaktuar në aktin noterial të kohës së kryerjes së këtyre veprimeve. Këtë qëndrim timin e përforcon bindshëm jurisprudenca e Kolegjit ndër vite, e cila u ka dhënë vlerë të plotë provuese akteve noteriale të kohës. Mbi këtë arsyetim, familja Abdiu do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive objekt shkëmbimi, të poseduara për një periudhë të gjatë kohore nga ana e tyre.

12. Si përfundim, subjekti i rivlerësimit, së bashku me familjen e tij, figuron pronar i ligjshëm në pasurinë e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” dhe posedues i rregullt i apartamenteve të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, që këtu, përveç analizës më sipër, rezulton se asnjëherë nuk ka pasur shkëmbim të këtyre pasurive, siç pretendon subjekti.

*II. Lidhur me pasurinë e paluajtshme shtëpi dykatëshe (një kat plus papafingo), e ndodhur në fshatin Golem, Kavajë, te kompleksi turistik “{\*\*\*}”:*

13. Rezultoi e provuar si në Komision, ashtu edhe në Kolegj, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e saj, në deklaratat periodike vjetore, deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në përgjigjet e dhëna në Komision.

13.1. Në deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 dhe 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar me burime: (i) nga shitja e një apartamenti në bashkëpronësi në Golem, Kavajë; dhe (ii) kursimet vjetore – duke specifikuar se në vitin 2004, është paguar shuma prej 4.000.000 lekësh në favor të shtetasit N. H., për blerjen e 1/2 pjesë të saj. Ndërkohë, nga hetimi i kryer, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë pasur në bashkëpronësi pasuri të llojit apartament të ndodhur në Golem, Kavajë.

13.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar nëpërmjet shkëmbimit me një pasuri tjetër dhe pagesës së shumës prej 4.000.000 lekësh, të bërë në favor të shtetasit N. H., për blerjen e 1/2 pjesë të saj, me burim të ardhurat e prindërve të tij – përfshirë këtu edhe kredinë e marrë nga babai në Bankën e Kursimeve. Ndërkohë, rezultoi e provuar se kjo kredi është transferuar plotësisht në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për likuidimin e vlerës së apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, si analizuar më sipër.

13.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se si burim i blerjes së kësaj pasurie, ka shërbyer shuma prej 40.000 USD, të cilën e ka përfituar nëna e tij nga shtetasi N. H., si rezultat i shitjes së pjesës së saj takuese në pasurinë e llojit vilë dykatëshe, të porositur/blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Gjithashtu, ka rezultuar se – nëpërmjet dokumentit noterial nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 9.3.2022, nëna e subjektit, znj. K. A., ndër të tjera ka deklaruar se: [...] Nga viti 2000, me kushëririn e bashkëshortit, shtetasin kosovar N. H., kanë blerë një banesë dykatëshe në një fshat turistik pranë

“{\*\*\*}”, në Golem. Pas një viti, kemi rënë dakord me bashkëpronarin që pjesën time takuese t’ia shes këtij të fundit kundrejt vlerës 40.000 dollarë amerikanë, pasi arrita një marrëveshje për të blerë një tjetër pasuri në Golem (te fshati turistik “{\*\*\*}”), të cilin e posedoj/disponoj aktualisht.

13.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka paraqitur një version tjetër për mënyrën e përfitimit dhe mbi burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi (vilës 2-katëshe në fshatin turistik “{\*\*\*}”, Golem, Kavajë). Kështu, duket se sipas deklarimeve të dhëna në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti pretendon se fillimisht, në vitin 2004, prindërit e tij i kanë blerë shtetasit N. H., pjesën që ai zotëronte te vila e ndërtuar nga “{\*\*\*}” ShPK, dhe se në vijim, në vitin 2005, prindërve të tij u është kthyer mbrapsht kjo shumë dhe se u është paguar edhe vlera prej 40.000 dollarësh nga shtetasi N. H., pasi hoqën dorë nga kjo pasuri. Ka deklaruar se vila 2-katëshe në fshatin turistik “{\*\*\*}”, Golem, Kavajë, është blerë në vitin 2005, në shumën prej 8.000.000 lekësh, me burim nga: (i) kthimi i shumës 4.000.000 lekë; (ii) kursimet e prindërve që dispononin nga pagat e vitit 2005; si dhe (iii) të ardhurat nga shitja e pjesës takuese të vilës së ndërtuar nga “{\*\*\*}” ShPK, kundrejt çmimit 40.000 USD.

13.5. Ndërsa, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie e vitit 2005, është bërë me qëllim regjistrimin e vilës në hipotekë – duke pretenduar se nuk ka pasur pagesë të çmimit të përcaktuar në kontratë (shuma prej 40.000 dollarësh) në atë vit – pasi kjo vilë ishte blerë nga prindërit e tij përpara se të lidhej kontrata e sipërcituar.

14. Bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të përmbushjes së objektit të kontrollit lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në mënyrë të saktë dhe plotë, çdo pasuri e të ardhur dhe burimin e krijimit të tyre, duke iu dhënë mundësia e korrigjimit të pasaktësive në deklaratat periodike vjetore. Në rastin konkret, ndonëse subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë për detyrimin kushtetues që mbartin subjektet e rivlerësimit në këtë proces për deklarimin saktësisht dhe plotësisht të pasurive të tyre dhe të personave të lidhur, duhet të kishte marrë masat e nevojshme për verifikimin paraprak të deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*. Një sjellje e tillë e përsëritur e subjektit të rivlerësimit, përveçse e çon atë në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, në interpretim *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, krijon konfuzion duke pamundësuar organet e rivlerësimit për të përcaktuar se cilat nga versionet e dhëna nga subjekti janë të vërteta.

15. Për këtë pasuri, vilë dykatëshe në Golem, Kavajë, shumica e trupit gjykues nuk është ndalur në asnjë moment të analizojë nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të kishin mundësi për krijimin e saj.

Unë, gjyqtarja në pakicë, në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie, konstatoj se qëndron konkluzioni i arritur nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, prindërit e subjektit të rivlerësimit, nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimet dhe shpenzimet e kryera deri në fund të vitit 2003 (përfshirë dhe pagesën e bërë për pasurinë objekt vlerësimi), si edhe investimet dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit 2005

(përfshirë dhe pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi). Në këto kushte, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmoj se, në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, deri në vitin 2003, në vlerën (-) 8.783.895 lekë, dhe për vitin 2005, në vlerën (-) 3.097.360 lekë të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*III. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}:*

16. Sikurse Komisioni dhe shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka investuar shumën 2.100.000 lekë për blerjen e kësaj pasurie dhe ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën (-) 1.117.048 lekë për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*IV. Lidhur me pasurinë e llojit “likuiditete” në formën e depozitës bankare me afat njëvjeçar, në Credins Bank, në shumën 20.000 euro, të investuar në datën 11.11.2016:*

17. Kundërshtoj konkluzionin e shumicës së trupit gjykues mbi besueshmërinë e pretendimit të subjektit të rivlerësimit për ekzistencën e kësaj shume monetare si gjendje *cash* në banesë dhe, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se qëndron konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, të llojit “depozitë” në Credins Bank, në shumën 20.000 euro, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin se argumentet e përdorura nga shumica në vendim, janë të pabazuara në ligj, dhe i konsideroj si shpjegime në funksion të vendimit të marrë. Konkretisht:

17.1. Tërheqja e shumës në maturim, nuk mund të jetë provë për mospërdorimin e tyre deri në fund të vitit. Në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë *vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar; në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, si dhe burimin e tyre.

17.2. Lidhur me termin e përdorur nga shumica, “kohë të shkurtër”, duke iu referuar periudhës nga data e tërheqjes së shumës 20.000 euro nga Credins Bank ShA më 10.12.2013 deri në 31.12.2013, vlerësoj se ky term nuk i përgjigjet faktit që kjo shumë është deklaruar si burim për krijimin e depozitës në të njëjtën vlerë pranë Raiffeisen Bank ShA, më datë 24.10.2014. Për më tepër, sikurse ka konstatuar Komisioni, deri në datën e krijimit të depozitës, subjekti ka shtuar si gjendje *cash* me të ardhurat e vitit 2014, shumën rreth 420.000 lekë dhe jo shumën e plotë prej 500.000 lekësh (deklaruar prej tij si shtesë likuiditetesh *cash* gjatë këtij viti), kjo në qasje të një metode alternative vlerësimi se kjo shumë është krijuar me shtesa kursimesh të përafërta për secilin muaj.

17.3. Me këtë arsyetim, vlerësoj të drejtë përfundimin e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme në vlerën (-) 2.485.871 lekë për të justifikuar krijimin e depozitës në shumën 20.000 euro, në datën 20.10.2014, në Raiffeisen Bank, pretenduar si burimi fillestar i krijimit të depozitës në shumën 20.000 euro, në Credins Bank, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e depozitës në Credins Bank, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*V. Për analizën financiare të periudhës së rivlerësimit 2003 - 2016*

18. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
19. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, problematikat e konstatuara në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar dhe qëndrimin të mbajtur gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, sjellja e subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit, kontradiktor në mënyrë të vazhdueshme, duke dhënë shpjegime të pabazuara në prova ligjore dhe në ligjin e zbatueshëm, nuk i bëjnë të zbatueshme parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit. Përkundrazi, në tërësinë e tyre, këto problematika: (i) deklarimi i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për pasurinë apartament banimi, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë; (ii) deklarimi i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për pasurinë vilë dykatëshe e ndodhur në Golem, Kavajë; (iii) mungesa e burimeve financiare të konstatuara për blerjen e automjetit “Mercedes Benz”; (iv) mungesa e burimeve financiare të konstatuara për krijimin e depozitës në shumën 20.000 euro; (v) mungesa e burimeve financiare të konstatuara për periudhën 2003-2016 për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, në vlerësimin tim, afektojnë besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
20. Në përfundim, gjej të drejtë konkluzionin e arritur nga Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, vlerësoj se vendimi nr. 543, datë 28.06.2022, i Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duhet të lihej në fuqi, në bazë të nenit 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*